

Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia

Ilja Luciak

Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia

Ilja Luciak



Geneva Centre for the
Democratic Control of
Armed Forces (DCAF)

Mbi Autorin

Dr. Ilja Luciak është Profesor dhe Dekan i Departamentit të Shkencave Politike, Instituti Politeknik i Virgjinias dhe Universiteti Shtetëror. Hulumtimi i tij fokusohet në politika krahasimore, politikën e Amerikës Latine, teoritë e zhvillimit, gjinia dhe demokratizimi, dhe ndryshimet politike me dhunë. Ai ka publikuar një numër të librave dhe artikujve mbi çështjet sikurse barazia gjinore dhe marrëveshjet e paqes, gjinia dhe demokracia në shtetet e Amerikës Latine, qeverisja demokratike dhe krijimi i aleancave të grave për rindërtimin e post-luftërave në Amerikën Qendrore. Ilja është Doktor i Shkencave në Shkenca Politike nga Universiteti i Iowa-së.

Editorët

Megan Bastick dhe Kristin Valasek, DCAF

Mirënjohjet

Do të dëshironim të falënderojmë njerëzit në vazhdim për komentet e tyre të çmueshme në përpilimin e këtij **mjeti praktik**. Hans Born, Willem F van Eekelen, Mahitab Mekkawi, Rita Taphorn, Tone Tingsgard dhe UN-INSTRRAW. Veç kësaj, dëshirojmë të falënderojmë Benjamin Buckland, Anthony Drummond dhe Mugihō Takeshita për asistencën në editim, dhe Anja Ebnother për udhëzimet e saj mbi projektin.

Disa seksione në këtë dokument bazohen në raportin konsultativ të përgatitur për Programin Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara të Ilja A. Luciak, "Konflikti dhe Përgjigja Parlamentare Gjinore" projekt mbi përforcimi i Rolit të Parlamentit në Parandalimet e Krizave dhe Rimëkëmbja, (New York:UNDP) prill 2006.

Mjet Praktik mbi Gjininë dhe RSS

Ky mjet praktik mbi Mbikëqyrjen Parlamentare të Sektorit të Sigurisë dhe Gjinisë është pjesë e Doracakut Praktik të Gjinisë dhe RSS. I dizajnuar të paraqes hyrje praktike tek çështjet e gjinisë në reformën e sektorit të sigurisë për praktikuesit dhe politikbërësit, Doracaku Praktik përfshin 12 Praktikrat dhe Shënimet korresponduese mbi praktikën:

1. Reforma Reforma e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia
2. Policore dhe Gjinia
3. Reforma Gjinore dhe Gjinia
4. Reforma e Drejtësisë dhe Gjinia
5. Reforma Penale dhe Gjinia
6. Menaxhimi i Kufijve dhe Gjinia
7. Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia
8. Politik-Bërja e Sigurisë Nacionale dhe Gjinia
9. Mbikëqyrja e Shoqërisë Civile e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia
10. Ushtritë Private dhe Kompanitë e Sigurimit dhe Gjinia
11. Vlerësimi i RSS, Monitorimi dhe Evaluimi dhe Gjinia
12. Trajnimi Gjinor për Personelin e Sektorit të Sigurisë Shtojcë mbi Ligjet dhe Instrumentet Ndërkombëtarë dhe Rajonal

DCAF, OSCE/ODIHR dhe UN-INSTRRAW janë mirënjohës për mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë për prodhimin e këtij Mjeti Praktik.

DCAF

Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) përkrah qeverisjen e mirë dhe reformën të sektorit të sigurisë. Qendra kryen hulumtime në praktika të mira, inkurajon zhvillime të normave të përshtatshme në nivel nacional dhe ndërkombëtarë, bën rekomandime të politikave dhe siguron këshilla në vend dhe programe përkrahëse. Partnerët e DCAF përfshijnë qeveritë, parlamentet, shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare dhe aktoret e sektorit të sigurisë si policia, gjyqësori, agjencitë e inteligjencave, shërbimet e sigurisë kufitare dhe ushtria.

OSCE/ODIHR

Zyra për institucione demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSCE-së për dimensionin human të sigurisë: koncept i gjerë që përfshin mbrojtjen e të drejtave të njeriut; zhvillimin e shoqërive demokratike, me theks të veçantë në zgjedhje, ndërtimin-institucional, dhe qeverisjen; përforcimi i sundimit të ligjit; dhe promovimi i respektit të mirëfilltë dhe mirëkuptimi i ndërsjellë ndërmjet individëve, si dhe popujve. ODIHR kontribuoi në zhvillimin e këtij mjeti praktik.

UN-INSTRRAW

Instituti i Hulumtimeve dhe Trajnimeve të Kombeve të Bashkuara për Avancimin e Grave (UN-INSTRRAW) është entiteti i vetëm i KB i mandatuar për zhvillimin e programeve të hulumtimit që kontribuojnë në fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore në të gjithë botën. Njëpërmjet ndërtimit të aleancave me Shtetet Anëtare të KB, organizatave ndërkombëtare, akademisë, shoqërisë civile, dhe aktorëve tjerë, UN-INSTRRAW

- Ndërmerr hulumtim të orientuar në veprim nga perspektiva gjinore që ka ndikim konkret në politika, programe dhe projekte;
- Krijon sinergji për menaxhimin e diturisë dhe shkëmbim të informatave;
- Përforon kapacitetet e pjesëmarrësve kryesorë për integrimin e perspektivave gjinore në politika, programe dhe projekte.

Foto kopertinë © Keystone, EPA, Herwing Vergult, 2006.

© DCAF, OSCE/ODIHR, UN-INSTRRAW, 2008.

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Cito si: Ilja Luciak. "Mbikëqyrja Parlamentare të Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia." *Mjet Praktik mbi Gjininë dhe Reformën e Sektorit të Sigurisë*. Eds. Megan Bastick dhe Kristin Valasek. Geneva: DCAF, OSCE/ODIHR, UN-INSTRRAW, 2008.

PËRMBAJTJA

Akronimet	6
1. Hyrje	7
2. Çka është Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë?	7
3. Pse janë çështjet gjinore të rëndësishme në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë?	9
3.1 Ligjet dhe politikat e sigurisë gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në nevoja	9
3.2 Institucione të sektorit të sigurisë efektive dhe të përfaqësuara	10
3.3 Menaxhimi i resurseve dhe buxheti i barabartë	11
3.4 Barazia gjinore në vendim-marrjen parlamentare	12
4. Si mund të integrohet gjinia në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë?	13
4.1 Të formulohen ligje dhe politika të sigurisë, gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në nevoja	13
4.2 Ndërtimi i institucioneve reprezentative dhe efektive të sektorit të sigurisë	14
4.3 Adresimi i dhunës së bazuar në gjini	15
4.4 Shtimi i përfaqësimit të grave në parlamente dhe në vendimmarrjen parlamentare për sigurinë	16
4.5 Zbatimi i prokurimit dhe buxhetimit të barabartë	18
5. Integrimi i gjinisë në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë në kontekste specifike	20
5.1 Vendet post-konflikte	20
5.2 Vendet e Zhvilluara	24
6. Rekomandime kryesore për parlamentarët	25
7. Burime plotësuese	26

Akronimet

CEDAW	Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave
CSO	Organizatat e Shoqërisë Civile
DDR	Procesi i Çarmatimit, Demobilizimit dhe Reintegrimit
GBV	Dhuna Bazuar në Gjini
IPU	Unioni Ndër Parlamentarë
NATO	North Atlantic Treaty Organization
NGOs	Organizatat Jo-Qeveritare
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KB	Kombet e Bashkuara

MBIKËQYRJA PARLAMENTARE E SEKTORIT TË SIGURISË DHE GJINIA

1 Hyrje

Parlamentet luajnë rol të rëndësishëm në reformën e sektorit të sigurisë. Si përfaqësues të interesave të qytetarëve, parlamentarët luajnë rol thelbësor legjislativ dhe mbikëqyrës, duke mbajtur ekzekutivin përgjegjës. Parlamentet aprovojnë buxhete, rishqyrtojnë dhe zbatojnë legjislacion që ndërlidhet me sektorin e sigurisë, dhe ushtrojnë funksion thelbësor në ndërlidhjen në mes të qeverisë dhe qytetarëve në formësimin e dialogut nacional mbi sigurinë. Ata janë të vetmit trupa të zgjedhur nga populli që mund të flasin për të gjithë qytetarët dhe të mbrojnë interesat e tyre të sigurisë. Kur parlamentarët marrin parasysh çështjet gjinore - të cilat përfshijnë një kuptim të nevojave të ndryshme të sigurisë të burrave, grave, vajzave dhe djemve - ata përforcojnë mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë. Mbikëqyrja bazuar në përgjegjësi-gjinore mund të sigurojë politika të sigurisë gjithëpërfshirëse, bazuar në nevoja; dhe ti mbajë ata përgjegjës për buxhet të paanshëm.

Ky mjet synon të nënvizoj rëndësinë e mbikëqyrjes parlamentare të sektorit të sigurisë dhe përfitimet që parlamentarët nxjerrin nga përfshirja e perspektives gjinore në punën e tyre. Audiencat kryesore në nivelin nacional përfshijnë parlamentarët, stafet parlamentare, dhe partitë politike. Anëtarët dhe stafi i trupave parlamentare rajonale, si Parlamenti Pan Afrikan, Parlamenti i Amerikës Qendrore, Parlamenti Evropian dhe Asambletë Parlamentare të OSCE dhe NATO janë gjithashtu audiencë e synuar; siç edhe janë institucionet dhe grupet e parlamentarëve, Asociacioni i Parlamentarëve Evropian për Afrikën, të cilët ndërmarrin aktivitete të asistencës parlamentare. Reforma qeveritare e sektorit të sigurisë dhe zyrtarët e qeverisjes së projekteve, organizatat e shoqërisë civile, hulumtuesit dhe akademikët që punojnë në ndërmarrjen e sigurisë, parlamentet dhe gjinitë do të gjejnë këtë mjet të përdorshëm.

Duke u bazuar në një diskutim të shkurtër në natyrën e mbikëqyrjes parlamentare të sektorit të sigurisë, ky mjet paraqet rëndësinë dhe dobitë e integritit të gjinisë në punën e parlamentarëve në çështje të sigurisë. Ai paraqet sugjerime mbi formën e integritit të çështjeve gjinore në mbikëqyrjen parlamentare, dhe përfshinë një seksion që adreson

çështjet gjinore dhe mbikëqyrjen parlamentare në kontekste specifike të vendeve post-konfliktuale dhe të zhvilluara. Mjeti përfundon me rekomandime thelbësore dhe paraqet një listë të resurseve shtesë për praktikues.

2 Çka është Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë?

Një definicion i rrënjësor i mbikëqyrjes parlamentare të sektorit të sigurisë thekson: 'Legjislatura ushtron mbikëqyrje parlamentare duke aprovuar ligje që definojnë dhe rregullojnë shërbimet e sigurisë dhe fuqitë e tyre dhe duke adoptuar buxhete të caktuara korresponduese. Një kontroll i tillë mund të përfshijë edhe themelimin e ombudspersonit parlamentarë ose një komision që mund të lançoj hetime në ankesa publike.¹

Qeverisja e mirë kërkon mbikëqyrje parlamentare. Parlamenti është në thelb të demokracisë, që shërben si mburojë kundër sundimit autokratik. Parlamenti mbanë fuqinë e kuletës dhe kështu determinon buxhetet mbi të cilat varet sektori i sigurisë. Për më tepër, ai krijon parametrat ligjorë për çështje të sigurisë. Varësisht nga vendet e ndryshme në diskutim, këto janë disa nga veprimet të cilat parlamenti mund ti ndërmarrë për të mbikëqyrë sektorin e sigurisë:²

- **Aprovimi, refuzimi apo propozimi i amendamenteve të politikave të sigurisë dhe ligjeve të mbrojtjes.**
 - Mbajtja e debateve parlamentare.
 - Shtrimi i pyetjeve parlamentare dhe bërja e interpelancave (kërko nga zyrtarët qeveritarë të shpjegojnë ndonjë akt apo politikë).
 - Thirrja për konsulta nacionale në çështje të sigurisë.
 - Hulumtim nga Komisionet.
- **Adoptimi dhe mbikëqyrja e dispozitave buxhetore që ndërlidhen me sigurinë.**
- **Autorizimi apo përfundimi i gjendjes emergjente**

apo luftës.

- Aprovimi ose refuzimi i propozimeve të qeverisë për:
 - Marrëveshjet ndërkombëtare, aleancat dhe dërgimi i trupave jashtë vendit.
 - Emërimi i personelit të lartë të sigurisë.
 - Prokurime të rëndësishme të armëve.
- Monitorimi dhe vlerësimi i politikave dhe programeve të sigurisë.
 - Inicimi i hetimeve parlamentare apo dëgjimeve.
 - Kërkimi i vlerësimit të zbatimit të politikave/programeve nga qeveria apo punësimi i kunsulentëve për të udhëhequr auditime speciale mbi efikasitetin e qeverisë.
 - Themelimi apo shqyrtimi i funksionimit të mekanizmave të auditimit p.sh. Ombudspersoni për mbrojtje.

Ekzistojnë aktorë të ndryshëm tjerë qenësorë brenda sistemit parlamentarë:

- **Parlamentarët**, apo anëtarët e parlamentit, janë përfaqësues të zgjedhur nga votat për parlament. Ata mund të sigurojnë që shqetësimet e qytetarëve të merren parasysh në politikat që ndërliken me sigurinë të propozuara nga ekzekutivi. Ata mund të mbajnë dëgjime publike, të sigurojnë informata përkatëse për shoqërinë civile dhe, në disa raste, ligjvënësit përdorin takime të qeverisë lokale për të diskutuar politikat qeveritare me zonat e tyre elektorale. Ky funksioni i fundit, duke shërbyer si urë për publikun – si në parti apo edhe në nivele individuale ligjvënëse – e përforcon shumë legjitimitetin e vendimmarrjes parlamentare në çështje të sigurisë.
- **Partitë politike** janë pjesët kryesore përbërëse të parlamentit. Tekstura organizative e shumicës së parlamenteve është e ndërthurur përreth tyre. Në shumicën e sistemeve politike, partitë politike, më shumë se parlamenti, janë shtylla kryesore ndërlidhëse në mes të vendim-marrësve dhe shoqërisë civile. Partitë politike kanë vendin e tyre specifik në sektorin e sigurisë dhe përdorin legjislativin si forum për të transmetuar betimet e tyre publikut.
- **Mbështetësit (stafi) parlamentarë** luajnë rol

qenësor në bërjen e parlamentit funksional. Stafi paraqet mekanizmin e brendshëm të ekspertizës në të cilin bazohen individët parlamentarë dhe partitë politike. Stafi profesional siguron vazhdimësi në diskutime komplekse të çështjeve të sigurisë dhe mund të sigurojnë vazhdimësi institucionale. Kështu, stafi është element qenësor në sigurimin e mbikëqyrjes efektive të sektorit të sigurisë.

- **Ombudspersonat parlamentarë** janë bërë mekanizma të rëndomtë në Evropë që luajnë GBV në funksionin e mbikëqyrjes parlamentare. Në Evropën Perëndimore, me përjashtim të Gjermanisë, Greqisë, Italisë, Luksemburgut dhe Zvicrës, të gjitha vendet kanë ombudsperson në nivelin nacional. Italia dhe Zvicra kanë ombudsperson në nivelin rajonal ose nivelin lokal, derisa Bundestagu Gjerman ka një Komision të Peticioneve i cili 'shërben si barazim funksional të ombudspersonit ushtarak për ankesa nga forcat e armatosura.³
- **Shoqëria civile** mund të jetë një partner efektiv në përkrahjen e parlamentarëve në përpjekjet për të reformuar sektorin e sigurisë. Parlamentet mund të përdorin metoda të ndryshme të bashkëpunimit me shoqërinë civile, përfshi mbajtjen e dialogjeve nacionale, organizimi i dëgjimeve publike parlamentare në ligjet e propozuara, ose thirrja e prezantimeve nga ekspertet. Marrëdhënie të tilla janë tradita të vendosura kohë të gjatë në shume shoqëri.

Ndryshimet në kapacitete të mbikëqyrjes parlamentare në mbarë botën janë evidente. Parlamentet me histori të gjatë të fuqisë së ligj-bërjes, legjitimitet i bazuar në mandate popullore të gjera dhe histori të mbikëqyrjes së fuqishme parlamentare të ekzekutivit, do të jenë më efektiv në ushtrimin e kontrollit mbi reformën e sektorit të sigurisë se sa parlamentet në shumë vende në zhvillim dhe në tranzicion që nuk funksionojnë në kushte të tilla të favorshme. Legjislaturat në vende të ndikuara nga konfliktet dhe shoqëri në tranzicion ballafaqohen më pengesa politike, kushtetuese, dhe resurse që pengojnë efikasitetin e tyre. Pavarësisht të metave strukturore dhe institucionale, parlamentet luajnë rol qenësor për të siguruar që reforma e sektorit të sigurisë të jetë një proces gjithë përfshirës.

Të gjitha parlamentet ballafaqohen me kompleksitete qenësore të çështjeve që ndërliken me reformën e sektorit të sigurisë dhe kështu ballafaqohen

me sfida të zakonshme në përpjekjet e tyre për të ushtruar mbikëqyrje efektive. Qoftë ai Kongresi i Shteteve të Bashkuara që përpiqet të rishkruaj Aktin PATRIOTIK të SHBA-ve në mënyrë që të mbizotërojë mbi një ekzekutiv të tej përkushtuar në përdhën pas 11 shtatorit, Parlamenti Evropian i brengosur për politikën e mbrojtjes së Bashkimit Evropian ose një legjislaturë Arabe duke kërkuar të imponoj autoritetin e vet pas konfliktit, të gjitha legjislatura ndajnë një mirëkuptim të kompleksiteteve më të cilat parlamentet ballafaqohen kur ata mundohen të vendosin kontroll mbi forcat ushtarake dhe policore. Parlamentet janë të limituara nga mungesa e ekspertizës si dhe në përparësinë që dega e ekzekutivit ka në fushën e sigurisë. Për shembull, presidentet dhe kabinetet e tyre shpesh përdorin ligjet e fshehtësisë në mënyrë që të pengojnë qasjen e lirë të parlamenteve në informata.

Në disa raste, sfida të mëdha paraqesin shanse të mëdha. Për shembull, situata të konflikteve paraqesin shanse të rëndësishme për parlamentet të jenë të përfshirë në mënyrë efektive në reformën e sektorit të sigurisë. Pas luftës civile ose formave tjera të ndërrimeve me dhunë politike, parlamenti ka mandat të gjerë në përfaqësimin e interesave të qytetarëve duke ushtruar funksionet e veta mbikëqyrëse dhe legjislative në mënyrë që të përmirësojë sigurinë njerëzore.

3 Pse janë çështjet gjinore të rëndësishme në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë?

Gjinia i referohet roleve specifike dhe marrëdhënieve, tipareve të personalitetit, sjelljeve dhe vlerave që shoqëria atribuon burrave dhe grave. 'Gjinia' kështu i referohet ndryshimeve të mësuara në mes burrave dhe grave, derisa 'seksi' i referohet ndryshimeve biologjike ndërmjet meshkujve dhe femrave. Rolet gjinore ndryshojnë shumë në dhe përgjatë kulturave, dhe mund të ndryshojnë në kohë. Gjinia nuk i referohet vetëm grave dhe burrave por marrëdhënieve ndërmjet tyre.

Përfshirja e gjinisë është proces i vlerësimit të implikimeve për gra dhe burra të çfarëdo veprimi, përfshi legjislacionin, politikën dhe programet, në të gjitha fushat dhe nivelet.⁴

Për më shumë informata shih
Mjetin mbi RSS dhe Gjinia

3.1 Ligjet dhe politikën e sigurisë gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në nevoja

Parlamentet e angazhuara në reformën e sektorit të sigurisë përfitojnë prej integritit të perspektives gjinore në funksionet e tyre qenësore. Parlamentarët, si përfaqësuesit e zgjedhur të elektoratit të vet, kanë përgjegjësinë të sigurojnë që nevojat e sigurisë të grave, burrave, djemve dhe vajzave janë të përfshira në politik-bërjen e sigurisë. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë ballafaqohen me kërcënime të ndryshme për sigurinë e tyre. Dhuna e bazuar në perspektivë gjinore (GBV) është një nga kërcënimet më të zakonshme të sigurisë njerëzore në mbarë botën. Burrat dhe gratë kanë qasje të ndryshme në sigurimin shëndetësor, edukim, fuqi vendim-marrëse dhe resurse tjera, që ndikojnë në çdo aspekt të sigurisë së tyre. Procesi i politik-bërjes nacionale të sigurisë shpesh fokusohet në adresimin e kërcënimeve të jashtme të sigurisë si terrorizmi dhe armët e shkatërrimit në masë, dhe përgatitja e forcës ushtarake. Ligjet dhe politikën që rregullojnë policimin, drejtësinë,

burgjet, shërbimet kufitare, inteligjencat, forcat e mbrojtjes dhe kompanitë e sigurimit privat janë shpesh të rregulluara pa vëmendje se si ato mund të ndikojnë ndryshe në segmentet e shumëllojshme të komunitetit. Megjithatë, parlamentarët mund të përdorin autorizimet e tyre mbikëqyrëse legjislative, buxhetore dhe fuqi tjera që të sigurohen se ligjet e sigurisë dhe politikat përmbushin nevojat e zgjedhësve të tyre, duke marrë parasysh GBV-në dhe aspekte tjera të qasjes së ndryshme të burrave dhe grave në siguri.

Përfshirja në rritje e grave në sektorin e sigurisë ngritë pyetje të reja për parlamentarët për tu konsideruar, përfshi çështje të trajnimit, kodit të veshjes dhe strehimit. Në të njëjtën kohë, ekzistojnë nevoja të sigurisë tradicionale që vetëm kohëve të fundit iu është dhënë vëmendje, si trajnim adekuat i personelit policor për t'ju përgjigjur dhunës familjare dhe formave tjera të GBV-së. Vëmendja ndaj këtyre çështjeve të rëndësishme gjeneron konfidencë dhe besim ndër sektorët tradicionalisht të marginalizuar në institucionet e qeverisë. Kjo edhe e përforcon legjitimitetin parlamentar.

Për më tepër, kur parlamentarët përfshijnë një gamë të gjerë të aktorëve të shoqërisë civile, përfshi përfaqësuesit e organizatave të grave, në procesin e politik-bërjes dhe atij ligjor, kjo rritë përfaqësimin dhe legjitimitetin e politikave të sigurisë, institucionet e sigurisë dhe vetë parlamenti (shih Katrori 1).

3.2 Institucione të sektorit të sigurisë efektive dhe të përfaqësuara

Parlamentet mund të ushtrojnë mbikëqyrje mbi përmbushjen e detyrave të personelit dhe institucioneve të sigurisë duke përkrahur edukimin, futja e kodit të mirësjelljes, vendosjen e mekanizmave llogaridhënës dhe rishqyrtimin e politikave të resurseve humane. Integrimi i çështjeve gjinore është qenësore për efikasitetin operacional dhe efikasitetin në sektorin e sigurisë-përfshi në forcat e armatosura, polici, autoritetet kufitare, gjyqësor dhe sistemin penal – dhe kështu duhet të monitorohet nga parlamenti. Institucionet e sektorit të sigurisë kanë treguar të jenë më efektive nëse rrisin pjesëmarrjen e grave dhe normë më të ultë të diskriminimit, ngacmimeve seksuale dhe dhunës. Pjesëmarrja e grave në shërbimet e sigurisë është gjithashtu aspekt qenësor i krijimit të institucioneve reprezentuese të sektorit të sigurisë, të cilat do të gëzojnë besim më të madh publik.

Shih Mjetin mbi Reformën e Policisë dhe Gjinia, Reforma e Mbrojtjes dhe Gjinia

Parlamentarët mund të vendosin masa proaktive të përgjegjësisë për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe ulur diskriminimin dhe dhunën. Për shembull, është roli i parlamentit për të miratuar ligje që sigurojnë që të gjitha pozitat në institucionet e sektorit të sigurisë,

Katrori 1 | Krijimi i politikave të sigurisë përgjegjëse ndaj gjinisë në Afrikën Jugore⁵

Procesi i reformimit të sektorit të sigurisë në Afrikën Jugore në periudhën post-apartheidit është marrë shpesh si shembull për përfshirjen dhe participimin e gjinisë.

Dokumenti i bardhë i vitit 1996 në Mbrojtjen Nacionale në Republikën e Afrikës Jugore është përpiluar nga Laurie Nathan i Universitetit të Kape Town. Drafti i parë i dokumentit është komentuar gjerësisht nga organizatat e shoqërisë civile dhe anëtarët e industrisë së mbrojtjes. Ai përfshiu një qasje në sigurinë njerëzore dhe theksoi krijimin e një kulture joseksiste, përfshi edhe obligimin e Ministrisë së Mbrojtjes të identifikoj dhe eliminoj praktikën diskriminuese dhe sjelljeve jo të hijshme në forcat e armatosura. Përveç kësaj, drafti ftoi për aksion firmues dhe programe për shanse të barabarta si dhe njohjen e të drejtave të grave në shërbimin në të gjitha gradat dhe pozitat, përfshi edhe role luftarake.

Dokumenti i bardhë gjithashtu ftoi për shqyrtim të mbrojtjes për të nënvizuar detajet operationale si doktrinën, dizajnimin i forcave, logjistika, armët, resurset humane dhe pajisjet. Në

instanca të parlamentarëve të gjinisë femërore dhe të tjerë, Komisioni i Përbashkët Funkcional Parlamentar për Mbrojtjen ftoi për konsulta nacionale si pjesë e procesit të rishqyrtimit të mbrojtjes. Një numër i masave ishin marrë për të siguruar pjesëmarrje publike, përfshi përdorimin e aeroplanëve ushtarak dhe autobusëve për transportimin e liderëve fetarë dhe të komunitetit, aktivistëve të OJQ-ve dhe përfaqësuesve të organizatave të grave në takime rajonale dhe punëtori.

Organizatave bazë të grave ishin energjike në tërheqjen e vëmendjes për çështjet që ishin injoruar më parë si ndikimi në ambientin e përdorimeve ushtarake dhe ngacmimeve seksuale të grave nga personeli ushtarak. Për tu përgjigjur në këto çështje dy nën-komisione të reja u formuan brenda Sekretariatit të Mbrojtjes. Pas një procesi dy vjeçar, kontrolli pjesëmarrës i mbrojtjes kishte ndihmuar në ndërtimin e konsensusit nacional përreth çështjeve të mbrojtjes dhe kishte gjeneruar legjitimitet publik për strukturat e reja të sigurisë.

Pas gjenocidit të Ruandës, reforma elektorale që përshin kuota legjislative ndihmoi në bërjen e Ruandës lider botëror në aspektin e përfaqësimit të grave në parlament, me 48.8 përqind e parlamentarëve gra.⁶ Eksperienca e Ruandës demonstroi ndryshimin që një numër i madh i parlamentarëve femra mund të bëjnë në rindërtimin e pas konfliktit. Gratë parlamentare formuan grupin e parë parlamentarë që tejkaloi linjat partiake dhe përfshiu si Hutus po ashtu edhe Tutsis. Grupi adresoi çështje të sigurisë së gruas, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike dhe partiake, duke iniciuar ligje mbi të drejtën e gruas për të trashëguar pronë, dhe të drejtën e vejshave për të kërkuar pronë nga të afërmit e burrave të tyre të vdekur, dhe GBV.⁷ Qeveria krijoi një ministri të dedikuar për fuqizimin e grave dhe një politikë nacionale për çështje gjinore ishte draftuar në vitin 2001. Kjo hapi rrugën që gjinia

të identifikohet një nga prioritetet ndërlidhëse në procesin e rishikimit të strategjisë për uljen e varfërisë. Qeveria përkrahi hulumtim të gjerë në aspekte të ndryshme të pengesave bazuar në gjini. Rezultatet ishin përfshirë në diskutime në çdo Ministri dhe departament të Qeverisë për barrierat e barazisë gjinore dhe si ato do të mund të tejkaloheshin. Si rezultat, Ministria e Bujqësisë është e angazhuar për të rritur numrin e grave të përkrahura nga programet e saj; Ministria e Edukimit është duke u munduar të rrisë numrin e vajzave që vazhdojnë shkollimin; strukturat e qeverisë rajonale janë të angazhuara të përkrahin përfaqësimin e grave në procesin e vendim-marrjes në pushtetin lokal; dhe ushtrime në buxhetimin e çështjeve gjinore janë përdorë për të trajnuar shërbyes civil për të përkthyer vendimet politike në vepra konkrete nëpërmjet akordimit të resurseve.⁸

përfshi edhe pozitat që përfshin luftime, janë të hapura për gra. Në vitin 2000, Parlamenti i Izraelit adoptoi Ligjin e amandamentuar mbi Shërbimin e Sigurisë i cili i hapi të gjitha profesionet ushtarake për gra.⁹ Në procesin e ushtrimit të kontrollit nga parlamenti mbi përbërjen dhe mandatin e misioneve paqeruajtëse, ata kanë rastin të thërrasin për rritje në pjesëmarrjen e femrave.

Ekziston bindje që misione të tilla janë më efektive kur anëtarët e tyre janë pajisur me trajnim mbi çështjet gjinore dhe forca përfshin gra në strukturën komanduese si dhe në vetë forcën. Ushtarët femra janë të prirura me qenë më të informuara për nevojat gjinore të popullatës që i shërbejnë dhe ekziston mundësi më e madhe që atyre t'ju afrohen sektorët e marginalizuar të shoqërisë.¹⁰

Parlamentet gjithashtu luajnë rol qenësor në parandalimin dhe mbajtjen e institucioneve të sigurisë përgjegjëse për diskriminim, ngacmim seksual dhe dhunë. Nga skandalet e paqeruajtësve të përfshirë në shfrytëzime seksuale dhe trafikim njerëzor, shkallë e lartë e ngacmimeve seksuale të grave brenda forcave të armatosura, deri tek sulme seksuale nga personeli i burgjeve, këto forma të GBV-së janë akte kriminale që ulin efikasitetin e shërbimeve të sigurisë. Si përgjigje, parlamentarët mund të adoptojnë politika që vendosin kode të mirësjelljes, nxjerrin ligje për masat disiplinore, themelojnë ombudspersonin për mbrojtje dhe/ose për çështje gjinore, thërrasin për hetime të thella dhe të monitorojnë që sanksionet janë duke u zbatuar.

Një shembull është rezoluta e Parlamentit Evropian për pjesëmarrjen e grave në zgjidhje paqësore të

konflikteve, e kaluar në vitin 2000. Ajo thërret vendet anëtare që të marrin aksione të ndryshme për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe përgjegjësitë gjinore në kontekst të iniciativave që ndërlidhen me paq dhe siguri. Përveç mandatimit e trajnimeve gjinore për personelin ushtarak dhe stafin e e angazhuar në politikat që ndërlidhen me konflikte, rezoluta thërret për rekrutim dhe nominim të më shumë grave në shërbime diplomatike dhe promovon përdorimin e ekipeve vetëm femra të paqeruajtësve, zbuluese dhe asistuese. Për sa i përket shkëlqes të drejtave njerëzore, rezoluta dënon sjelljet e këqija seksuale të ushtarëve të përfshirë në operacione paqeruajtëse; thërret për masa kundër trafikimit; dhe rekomandon që vëzhguesit e të drejtave të njeriut shoqërojnë paqeruajtësit për tu siguruar që ligji ndërkombëtarë është duke u zbatuar.

3.3 Menaxhimi i resurseve dhe buxheti i barabartë

Parlamentet adoptojnë dhe mbikëqyrin buxhetet që ndërlidhen më sigurinë. Kontrolli i buxhetit është një ndër mënyrat më të rëndësishme me të cilën ata mund të influencojnë politikat qeveritare.¹¹ Komisionet parlamentare gjithashtu luajnë rol të rëndësishëm në prokurimin e pajisjeve ushtarake dhe armëve. Analizimi i buxhetit për forcat ushtarake dhe policore nga vështrimi gjinor – i njohur si buxhetimi gjinor – mund të jetë një mjet i rëndësishëm për të ndihmuar parlamentet të njohin nevojat e ndryshme të sigurisë të grave, burrave, djemve dhe vajzave dhe të sigurohen që ato janë duke u prioritetizuar dhe pajisur në mënyrë adekuate. Kjo mund edhe të nënvizoj nëse iniciativat gjinore, si pajisja me trajnim gjinor për personelin e sektorit të

sigurisë, kanë fonde të mjaftueshme të alokuara.

Buxheti për çështje gjinore mbetet sfidë pasi që vendim-marrja ekonomike në vete është shumë larg nga balancimi gjinor. Si në rastin e portofolave thelbësor të sektorit të sigurisë, gratë janë shumë më të pa përfaqësuar kur bie fjala te vendim-marrja ekonomike. Deri në vitin 2005, vetëm njëzet gra në mbarë botën kishin portofola në financa dhe buxhet.¹² Prapë, mbi pesëdhjetë vende kanë miratuar iniciativa për buxhet bazuar në çështje gjinore, me pothuajse gjysmën e tyre që kanë institucionalizuar programe të tilla.¹³ Ndër shtetet anëtare të Këshillit të Evropës vendet Nordike, Austria, Belgjika, Franca, Gjermania, Britania e Madhe, Irlanda, Polonia, Spanja, Zvicra dhe Turqia të gjitha kanë zbatuar iniciativa për buxhet bazuar në çështje gjinore.¹⁴

3.4 Barazia gjinore në vendim-marrjen parlamentare

Për të forcuar legjitimitetin dhe përfaqësimin e mbikëqyrjes parlamentare të sektorit të sigurisë, ekziston nevoja që të rritet numri i parlamentarëve femra. Pariteti formal gjinor në vendim-marrjen politike, pavarësisht disa përmirësimeve në përfaqësimin e grave në vitet e fundit, mbetet ende një synim i largët. Domethënës ka qenë zbritja e përqindjes së parlamentarëve me më pak se 10% përfaqësim nga femrat nga 63% në vitin 1995 në pothuajse 30% në vitin 2007.¹⁵ Në të njëjtën kohë, ekzistojnë ende shtatë vende (në mesin e atyre që IPU ka vërtetuar të dhëna) që nuk kanë asnjë grua në parlament.

Në vitin 2007, më pak se 20% e parlamentarëve të botës ishin gra (shih Tabelën 1).

Vetëm vendet Nordike kanë parlamente me kompozim gjinor që vazhdimisht i afrohet barazisë gjinore. Kohëve të fundit Ruanda i është bashkuar këtij grupi elitë dhe ka zgjedhur parlament që ka përfaqësim të barabartë të burrave dhe grave (Shih katrorin 2). Edhe pse përparim i madh është bërë që nga viti 1995, kur përqindja e grave në parlament ishte pak më shumë se 11%, boshllëku gjinor është ende i madh.

Mungesa e bilancit gjinor në trupat vendim-marrëse legjislative dhe ekzekutive të botës është një pengesë strukturore në bërjen e vendim-marrjes parlamentare të sigurisë dhe mbrojtjes më të përfaqësuar. Në përgjithësi, gratë kanë një numër të vogël të pozitave ministrore në tërë botën, një çekuilibrim që është shumë i dukshëm në fushat e

mbrojtjes dhe të drejtësisë. Në vitin 2005, nga 183 shtetet të vlerësuara, vetëm 12 gra udhëhoqën ministri të mbrojtjes dhe punëve veterane dhe ishin vetëm 29 ministre të drejtësisë. Nga të dhënat raportuese të 97 parlamenteve mbi përbërjen gjinore të komisioneve parlamentare në vitin 1997, vetëm 3% kishin gra udhëheqëse të komisioneve të mbrojtjes. Në përgjithësi, më pak se 20% e të gjithë anëtarëve të komisioneve parlamentare ishin gra.¹⁷ Kështu një sfidë është përfshirja e një numri më të madh të parlamentarëve femra në komisione të sigurisë dhe të dominohen gratë në portofole qenësore të sigurisë, mbrojtjes, policisë dhe drejtësisë.

Një pjesëmarrje më e barabartë e burrave dhe grave në procesin e mbikëqyrjes demokratike forcon legjitimitetin e vendim-marrjes parlamentare. Kështu që, parlamentet përfitojnë vetvetiu nga adresimi dhe sigurimi formal i marrëdhënieve të barabarta që gjinden në shoqëri, barazia ligjore në mes grave dhe burrave.

Tabela 1 Përbërja gjinore e parlamenteve të botës, 2007 (unikameral ose dhoma e ulët)¹⁶

Rajoni	% e femrave AP	% e meshkujve AP
Vendet Nordike	41.6	58.4
Evropë OSCE	20.4	79.6
Vendet Nordike të përfshira		
Amerika	20.0	80.0
Evropë OSCE (pa vendet Nordike)	18.4	81.6
Afrika e Sub-Saharës	17.2	82.8
Azia	16.6	83.4
Pacifiku	13.1	86.9
Shtetet Arabe	9.6	90.4
Mesatarja Botërore	19.6	80.4

*'Si parlamentare, gratë mund të luajnë një rolë qenësor në kërkimin e përgjegjësisë dhe transparencës nga shërbimet e sigurisë; determinimin e buxhetit dhe politikave për tu siguruar që harxhimet ushtarake nuk marrin resurset nga çështjet zhvillimore siç janë edukimi, ambienti, shërbimet sociale dhe shërbimet shëndetësore; përfshirjen e publikut në debat dhe dialog në këto çështje; dhe sigurimi i përfaqësimit demokratik në strukturat e reja të sigurisë. Në Afrikën Jugore, gratë parlamentare promovuan pjesëmarrjen publike në procesin e reformës duke përfshirë OJQ-të në formulimin e politikave të reja. Ato gjithashtu kanë marrë një qëndrim, duke kërkuar sinqeritet dhe transparencë kur marrëveshjet për armë u përfunduan pa debat publik dhe deklarimet për korrupsion ishin shumë të zemëruara. Gratë gjithashtu kritikuan qeverinë për harxhimin e fondeve të pamjaftueshme në armatim përkundër zbutjes së varfërisë, dhe një parlamentare femër dha dorëheqje si shenjë proteste për marrëveshje.'*¹⁸

Në përfundim, përfshirja e gjinisë në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë është qenësore për qeverisje të mirë dhe zhvillim të qëndrueshëm. Për shembull, ekziston një lidhje në mes të barazisë gjinore dhe niveleve të ulta të konflikteve ndër-shtetërore. Duke marrë aspektet gjinore në perspektivë në reformimin e sektorit të sigurisë i bënë konfliktet në të ardhmen më të pamundshme.

Drejhtësia gjinore në vendim-marrje, përfshi edhe në sektorin e sigurisë, është fitimprurëse për të gjithë anëtarët e shoqërisë. Siç është pohuar, 'sa më e lartë shkalla e përfaqësimit të femrave në parlament, aq më e ulët shkalla shteteve që përfshihen në konflikte në mesë shtetesh do të jetë.'¹⁹

Pajtimi me obligimet e ligjit dhe instrumenteve ndërkombëtarë
Përfshirja e çështjeve gjinore në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë është gjithashtu domosdoshmëri në pajtim me ligjet ndërkombëtare dhe rajonale, instrumentet dhe normat që mbulojnë sigurinë dhe çështjet gjinore. Instrumentet kyçe përfshijnë:

- Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (1979)
- Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim (1995)
- Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 mbi Gra, paqja dhe Siguria (2000)

Për më shumë informata, ju lutem shiheni Shtojcën e Mjetit Praktik mbi Ligjet Ndërkombëtare dhe Rajonale dhe Instrumentet

4 Si mund të integrohet gjinia në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë?

Të gjitha vendet, pavarësisht nëse kanë gëzuar periudhatë gjatë të paqes dhe qeverisjes demokratike ose kanë dalë së fundi nga konfliktet e dhunshme, duhet të konfrontohen me çështje komplekse, dhe të vështira në aspektin e sektorit të sigurisë. Në të njëjtën kohë, sfidat specifike dhe mundësitë të cilat përfshijnë mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë dallojnë mes shteteve të ndryshme. Prandaj cilado strategji duhet t'i adaptohet kontekstit të reformës specifike. Për shembull, në shumë shoqëri të zhvilluara çështja e përfshirjes së grave në forcat policore dhe ushtarake si dhe paga e barabartë ose mundësitë e avancimit shpesh kanë përparësi, përderisa në shoqëritë e ndikuara nga konflikti pyetja se si të mbrohen gratë nga dhuna e bazuar në gjini (GBV), e keqësuar nga lufta mund të dominojnë agjendën e atij vendi. Kjo pjesë paraqet disa strategji praktike, ndërsa kontekstet specifike janë elaboruar në pjesën 5.

4.1 Të formulohen ligje dhe politika të sigurisë, gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në nevoja

Është rol i parlamentit të prezantoj interesat divergjente prezentë në shoqëri dhe 'të përdorë aftësinë që ka për të ndërtuar marrëdhënie brenda vetë parlamentit dhe komuniteti më gjerë.'²⁰ Në këtë kohë, parlamentet 'shpesh dhe në mënyrë jo adekuate i angazhojnë aktorët jo qeveritarë.'²¹ Parlamentet në shoqëritë e prekura nga konflikti, në veçanti kanë tendencë të kenë marrëdhënie të dobëta me elektoratin e tyre. Shumë parlamentarë kontaktojnë me votuesit e tyre vetëm gjatë periudhës së zgjedhjeve. Në mënyrë që të forcojnë legjitimitetin e tyre, parlamentet duhet të takojnë elektoratin e tyre, 'të ngrejë marrëdhëniet mes parlamentit dhe partnerëve tjerë qeverisës siç është shoqëria civile.'²²

Në kontekst të vendeve në tranzicion dhe të prekura nga lufta, shoqëria civile ka filluar të luaj rol më aktiv. Disa parlamente Afrikane duke përfshirë atë të Liberisë, Somalisë dhe Zimbabvesë, janë angazhuar në mënyrë të dukshme me organizatat e shoqërisë

civile. Po ashtu edhe në Amerikën Qendrore mund të gjejmë angazhime të ngjashme mes parlamenteve dhe organizatave jo qeveritare. Megjithatë iniciativa për këto dialogje ende vjen rrallë nga parlamenti.²³

Nga perspektiva e gjinisë, organizatat e grave janë aleatë kyç në përpjekjet e parlamenteve për të forcuar barazinë gjinore. Politikat që i përgjigjen gjinisë të miratuara nga parlamenti shumë shpesh e kanë origjinën e tyre në propozimet që burojnë nga shoqëria civile, e cila si rrjedhojë ka interes për ta ndihmuar zbatimin e tyre. Për shembull, në shumë vende grupet e grave angazhohen aktivisht në fushatat kundër GBV. Si rezultat, ato parlamente të cilat kanë forcuar ligjet e tyre kundër dhunës familjare mund të llogarisin në përkrahjen e grupeve të grave në zbatimin e këtyre ligjeve.

Parlamentet luajnë rol kyç në arritjen e sigurisë gjithëpërfshirëse duke kaluar ligje dhe politika që i përgjigjen gjinisë. Strategjitë praktike përfshijnë:

Proceset pjesëmarrëse

- Ndërtimin e mekanizmave për debate publike dhe konsultime, si p.sh. dëgjime publike, për të ndihmuar ndikimin e shoqërisë civile në politikat lidhur me mbrojtjen, policinë, menaxhimin e kufijve, drejtësinë dhe çështjet penale.
- Inkurajimin e organizatave të grave për pjesëmarrje në proceset konsultative të politikave.
- Parlamentarë individual mund të vihen në dispozicion për të dëgjuar shqetësimet që kanë organizatat e grave urbane dhe ato rurale.

Politikat dhe ligjet e sigurisë me aspekt gjinor

- Përfshirja e përmbajtjes gjinore në ligjet dhe politikat e sigurisë, siç është adresimi i GBV dhe promovimi i plotë dhe i barabartë i pjesëmarrjes së burrave dhe grave në institucionet e sektorit të sigurisë.
- Përdorimi gjithëpërfshirës ('zyrtarët policor') dhe specifik i gjuhës gjinore ('personeli mashkullor dhe femëror ushtarak') sipas nevojës.
- Kërkimi i këshillave nga ekspertët gjinor në hartimin dhe shqyrtimin e politikave të sigurisë.
- Të bëhet vlerësimi i ndikimit gjinor i politikave ekzistuese dhe atyre të propozuara të sigurisë.

Trajnimi gjinor dhe mandatet për politik-bërësit e sigurisë

- Të sigurohet që parlamentarët dhe stafi i tyre, posaçërisht ata të komitetit të mbrojtjes dhe sigurisë të trajnohen në çështjet e gjinisë dhe sigurisë.
- Të sigurohet që komitetet e mbrojtjes dhe sigurisë përfshijnë çështjet gjinore në mandatin e tyre.

Shih Mjetin Politikbërja dhe Gjinia në Sigurinë Kombëtare

4.2 Ndërtimi i institucioneve reprezentative dhe efektive të sektorit të sigurisë

Institucionet efektive të sigurisë janë edhe reprezentative edhe kuptojnë nevojat gjinore të sigurisë të popullatës ku shërbejnë. Efikasiteti operacional mund të forcohet nëse merret për bazë gjinia, në veçanti përmes përpjekjeve për të rritur përfaqësimin e grave dhe për të zbatuar trajnimin gjinor.

Gratë kanë tendencë të jenë minoritet i dalluar në institucionet e sektorit të sigurisë, duke përfshirë policinë, forcat ushtarake, institucionet gjyqësore dhe penale si dhe shërbimet kufitare. Për shembull gratë police përbëjnë vetëm 4 % të Forcës Policore Kombëtare të Ruandës.²⁴ Parlamentet mund të thërrasin për kuota dhe masa tjera të diskriminimit pozitiv për ta ndryshuar përbërjen e aparatit të sigurisë. Për shembull para luftës nuk ka pas gra police në Kosovë.²⁵ Kuotat u krijuan me sukses dhe tani gratë përbëjnë 14% të forcës policore të këtij territori të administruar nga OKB-ja, gjë që i atribuohet prezantimit të kuotave mandatore.²⁶ Sipas sistemit të ri, 20% të të gjithë të rekrutuarve duhet të jenë gra.²⁷ Liberia ka miratuar kuotën 20% për përfshirjen e grave në polici dhe forca të armatosura. Në vitin 2004 kanë qenë vetëm 11 gra gjyqtare ndaj 31 burrave gjyqtarë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Asambleja Parlamentare e Evropës ka miratuar një rezolutë sipas së cilës nuk do t'i konsideronte listat e kandidatëve të cilat nuk përfshijnë së paku një kandidatë të secilës gjini. Kjo rregull ka ndryshuar një vit më vonë, ku u lejuan listat e kandidatëve për një gjini me kushtin që ato të jenë nga gjinia më pak e përfaqësuar në Gjykatë (aktualisht gra).

Përveç fokusimit në rekrutimin e shtuar të grave, iniciativa tjera shtesë janë të domosdoshme për të krijuar një kulturë institucionale jo diskriminuese e cila mund të ndihmojë mbrojtjen dhe avancimin e grave. Një iniciativë kyçe në këtë fushë është trajnimi gjinor. Parlamentet aprovojnë buxhetet për programet e trajnimit në sektorin e sigurisë dhe mund të përdorin funksionin e vet mbikëqyrës për të apeluar në përfshirjen e trajnimeve specifike për gjininë si dhe në përfshirjen e çështjeve gjinore në kurrikulumin bazë të trajnimit. Për shembull, femrat liderë në Burundi kanë avokuar gjatë negociatave për paqe se është esenciale për forcat e sigurisë të 'kenë trajnim moral, teknik dhe civil...me theks të veçantë në mbrojtjen e grave dhe fëmijëve.²⁸

Strategjitë praktike përfshijnë:

Trajnimin gjinor për personelin e sektorit të sigurisë

- Të sigurohet që i tërë personeli i sektorit të sigurisë është i trajnuar në ndjeshmërinë e çështjeve gjinore.

Shih Mjetin për Trajnimin Gjinor për Personelin e Sektorit të Sigurisë

Iniciativat për të rritur rekrutimin, ruajtjen dhe avancimin e grave

- Të monitorohet implementimi i përkushtimeve ndërkombëtare, rajonale dhe nacionale sa i përket pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë të grave.
- Të sigurohet që legjislati që rregullon pjesëmarrjen në institucionet e sektorit të sigurisë avancojnë pjesëmarrjen e grave dhe grupeve tjera të përjashtuara dhe më pak të përfaqësuara.
- Të ushtrohet mbikëqyrja ndaj politikave të burimeve njerëzore dhe rekrutimit, trajnimit dhe menaxhimit të institucioneve të sektorit të sigurisë. Këto janë elemente qenësore për të siguruar që institucionet e sektorit të sigurisë avancojnë pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë të grave dhe burrave, operojnë me efikasitet, janë jo diskriminuese dhe adresojnë pasiguritë e bazuara në gjini.
- Ftesa për objektiva mandatorë në rritjen e përfaqësimit të grave në institucione të sektorit të sigurisë.

4.3 Adresimi i dhunës së bazuar në gjini

Parlamentarët e përfshirë në reformën e sektorit të sigurisë duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë GBV, si dhe ligjeve për pronën në tokë, trashëgiminë, martesën dhe orientimin seksual.

Shih pjesën për Reformën e Ligjeve në Mjetin për Reformën e Gjyqësisë dhe Gjinisë

Caroline Moser ka theksuar se 'gratë dhe burrat si aktorë shoqëror përjetojnë dhunën dhe konfliktin edhe si viktimë edhe si shkelës (fajtor).²⁹ Është më se mundshme që forcat reprezentative të sigurisë të jenë të njoftuara dhe më të ndjeshme ndaj ndikimit të GBV, kur është në pyetje dhuna familjare në Evropën Perëndimore dhe SHBA ose efekti i dhunimeve gjatë luftës në Afrikë apo Ballkan.

Parlamentet mund të adresojnë GBV duke siguruar që ligjet aktuale i njohin shkeljet e tilla dhe duke nxjerrë legjislati të ri i cili përfshin të gjitha format e GBV dhe themelon sanksione adekuate për fajtorët. Gjatë rindërtimit të sistemeve të gjyqësisë parlamentarët mund të sigurojnë që GBV është e përfshirë në mandatin e komisioneve të së vërtetës dhe gjykatave speciale të cilat janë krijuara pas luftës. Më tutje, parlamenti mund të shërbejë si forum për të shtuar vetëdijen shoqërore për ndikimin e dhunës gjinore.

Bouta, Frerks dhe Bannon kanë theksuar se 'politikave e GBV duhet të vejnë në shënjestër edhe gratë edhe burrat' në mënyrë që të 'arrijnë të gjithë aktorët e përfshirë (të mbijetuarit, të mbijetuarit në familje, dëshmitarët dhe fajtorët).³⁰ Edhe pse dihet që burrat preken nga GBV, politikave ekzistuese dështojnë t'i marrin për bazë nevojat e viktimave burra.³¹ Prandaj në mbështetje të sigurisë gjithëpërfshirëse, parlamentarët duhet të drejtojnë vëmendjen tek të mbijetuarit meshkuj dhe femra të dhunës seksuale.

Forcat e reja policore kërkojnë trajnim për të qenë më efektive në përgjigjen ndaj krimeve të bazuara në gjini. Për ta njohur këtë realitet, programe specifike të trajnimit zbatohen në vendet përreth botës. Për shembull, në vitin 2002, një e treta e forcës policore të Ruandës është trajnuar në fuqizimin e përgjigjeve ndaj rasteve që kanë të bëjnë me krimet seksuale dhe që janë të bazuara në gjini.³² Po ashtu duhet të vendosen mekanizma për ta parandaluar personelin e sektorit të sigurisë nga kryerja e GBV-së dhe për t'i

mbajtur përgjegjës për krimet e tyre.

Strategjitë praktike përfshijnë:

Kalimin e legjislacionit gjithëpërfshirës për parandalimin dhe dënimin e GBV

- Të sigurohet që të gjitha format e dhunës së bazuar në gjini duke përfshirë dhunimet në martesë, dhunimet burri ndaj burrit, shtatzënia e dhunshme dhe abortimet, 'vrasjet për nder' janë krimet me dënime proporcionale me seriozitetin e tyre.
- Të sigurohet që definicionet ligjore të dhunimit dhe shkeljeve tjera seksuale janë neutrale nga aspekti gjinor dhe se shkeljet seksuale trajtohen njëtrajtësisht pavarësisht a ndodhin ato me apo jashtë marrëdhënies sentimentale.
- Të monitorohet zbatimi i përkushtimeve ndërkombëtare, rajonale dhe nacionale lidhur me eliminimin e GBV.

Institucionet e sigurisë dhe personeli i tyre të mbahen të përgjegjës për parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës të bazuar në gjini

- Të sigurohen legjislacion dhe kode të qarta të mirësjelljes mbi përgjegjësitë e personelit të sektorit të sigurisë lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut duke përfshirë procedurat disiplinore.
- Të monitorohen ankesat, hetimet dhe dënimet e shkeljeve të drejtave të njeriut nga ana e personelit të sektorit të sigurisë me synimin që të ndalet mosndëshkimi për GBV.
- Te krijohen kërkime/studime mbi natyrën dhe shtrirjen e GBV dhe diskriminimi brenda institucioneve të sektorit të sigurisë.

Ombudspersoni

- Të merret në konsideratë krijimi i pozitës siç është ajo e Ombudsonit me autorizime të veçanta në mbikëqyrjen e integritetit të çështjeve gjinore brenda institucioneve të sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë dhe/ose të sigurohet që çfarëdo pozite e tillë mbikëqyrëse të ekzaminohet çështjet gjinore. Ombudspersonat parlamentarë janë institucionalizuar në shumë vende. Në Gjermani për shembull, një ombudsperson i veçantë merret me çështjet e forcave të armatosura. Ombudspersonat mund të jenë avokat efektiv dhe të luajnë rol kyç në theksimin e ndikimit të dhunës familjare dhe krimeve të lidhura me konfliktin.

4.4 Shtimi i përfaqësimit të grave në parlamente dhe në vendimmarrjen parlamentare për sigurinë

Parlamenti mund të ndërmerr një sërë veprimesh për të shtuar numrin e parlamentarëve femra si dhe për të shtuar pjesëmarrjen e tyre në komisionet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë. Për shembull, parlamentarët mund të dekretojnë reformat zgjedhore të cilat sigurojnë përfshirjen e plotë të grave dhe minoriteteve në proceset politike. Konsideratë e rëndësishme për parlamentet është lloji i sistemit zgjedhor që do të përdoret si dhe prezantimi i kuotave elektorale dhe partiake.

Kuotat elektorale luajnë rol të rëndësishëm në ndryshimin e përbërjes gjinore të parlamenteve botërore. Rreth dyzetë vende kanë kuota gjinore kushtetuese ose elektorale për zgjedhjet parlamentare.³³ Siç është thënë shumë shpesh, është e rëndësishme për pjesëmarrjen e femrave në parlament që të arrijnë 'masën kritike' – që konsiderohet të jetë rreth 30%. Argumenti i 'masës kritike' thotë që për të pasur gratë ndikim substantiv në vendimmarrjen parlamentare, ato duhet të jenë prezente në numër domethënës. Prej Gushtit 2007, tetëmbëdhjetë vende kanë arritur ose tejkaluar 30% të përfaqësimit të grave në parlament (shih tabelën 2).

Komisionet parlamentare u japin ligjvënësve mundësinë për të organizuar punën e tyre dhe për të përqendruar përvojën. Parlamentarët mund të përdorin komisionet e mbrojtjes dhe sigurisë për të ushtruar funksionin e vet të mbikëqyrjes duke ju kërkuar këtyre të dëshmojnë për efikasitetin operacional të forcave të sigurisë apo duke kërkuar të dhëna profesionale nga ekspertët të jashtëm për çështje të sigurisë. Pjesëmarrja e parlamentarëve femra në këto komisione është aspekt kyç i pjesëmarrjes së plotë të grave në vendimmarrjen e sigurisë.

Një sërë iniciativash mund të ndërmerrren për të siguruar që komisionet parlamentare të kenë barazi gjinore duke përfshirë kuotat. Për shembull, në vitin 2005, Knesset-i, parlamenti Izraelit ka miratuar amendamentin në Ligjin e vitit 1956 për Përfaqësimin e Barabartë të Grave i cili mandaton përfshirjen e grave në ekipet e emëruara për përcaktimin e politikave vendore, të huaja apo të sigurisë si dhe negociatave për paqe. Dy anëtarë të parlamentit inician ligjin në bashkëpunim me Isha L'isha, një organizatë bazë e grave. Në mënyrë që të kalohet

Tabela 2 Transformimi i parlamenteve: vendet që arrijnë 30%, 2007³⁴			
Vendi	Sistemi elektoral	Ekzistimi i kuotave(!)	% Gra në PN(?)
Ruanda	Pluralitet: i pari që e kalon postin	PO Modeli 1: Kushtetuta përcakton kuota për gra Modeli 2: 24 vende prej 80 janë të rezervuara për gra në Parlamentet Nacionale Modeli 3: 20% e këshilltarëve të qarkut janë të rezervuara për gra	48.8 (2005)
Suedia	Përfaqësimi proporcional: Sistemi i listave	PO Modeli 4: 50% kuota për gra në Partinë Social Demokrate të Punës, Partinë e së Majtës dhe Partinë e Gjelbër	47.3 (2006)
Finlanda	Përfaqësimi proporcional: Sistemi i listave	JO	42.0 (2007)
Kosta Rika	Përfaqësimi proporcional: Sistemi i listave	PO Modeli 2: 40% kuota për gra në të gjitha zgjedhjet publike. Modeli 4: 40% kuota për gra në Partinë e Çlirimit Nacional dhe Partinë e Unitetit Kristian-Social; 50% në Partinë e Aksionit Qytetarë	38.6 (2006)
Norvegjia	Përfaqësimi proporcional: Sistemi i listave	PO Modeli 4: 40% kuota për gra në Partinë Socialiste të Majtë, Partinë Punëtore të Norvegjisë, partinë e Qendrës, dhe Partinë Popullore Kristiane.	37.7 (2005)
Danimarka	Përfaqësimi proporcional: Sistemi i listave	JO Ka pasur Modelin 4. Kuotat janë braktisë rreth vitit 1996	36.9 (2005)
Belgjika	Përfaqësimi proporcional: Sistemi i listave	PO Modeli 2: Një e treta minimum kuota për të dy sekset; dy pozitat më të larta në listën partiake nuk mund të mbahen nga seksi i njëjtë. Modeli 4: 50% e kuota për femra në Partinë Socialiste Flamene dhe Partinë Socialiste Franceze	36.7 (2007)
Holanda	Përfaqësimi proporcional: sistemi i listave	PO Modeli 4: Partia Laburiste ka 50% kuota për femra; e Majta e Gjelbër ka kuota për femra gjithashtu (% nuk është e konfirmuar)	36.7 (2005)
Kuba	Shumica: sistemi dy raundesh	JO	36.0 (2005)
Spanja	Përfaqësimi proporcional: Sistemi i listave	PO Modeli 4: Partia Socialiste Punëtorëve të Spanjës ka 40% kuota për të dy sekset.	36.0 (2005)
Argjentina	Përfaqësimi proporcional: Sistemi i listave	PO Modeli 1: Kushtetuta vendosë kuota për gra. Modeli 2: 30% e listave partiake duhet të përfshijë gra në pozita fituese. Modeli 3: Ligjet kapitale dhe provinciale përfshijnë kuota. Modeli 4: Shumica e partive kanë adoptuar 30% kuota për femra.	35.0 (2005)
Mozambiku	Përfaqësimi proporcional: sistemi i listave	PO Modeli 4: Fronti për Çlirimin e Mozambikut ka 30% kuota për femra	34.8 (2005)
Afrika e Jugut	Përfaqësimi proporcional: sistemi i listave	PO Modeli 4: Kongresi Nacional i Afrikës ka 30% kuota për femra, 50% kuota për femra në listën partiake në nivelin lokal	32.8 (2005)
Austria	Përfaqësimi proporcional: sistemi i listave	PO Modeli 4: Alternativa e Gjelbër ka 50% kuota për gra; Partia Popullore e Austrisë ka 33.3% dhe Partia Social Demokratike e Austrisë ka 40%.	32.2 (2006)
Zelanda e Re	Anëtarët miks sistemi proporcional	PO Modeli 4: Kuota vullnetare të partive	32.2 (2005)
Islanda	Përfaqësimi proporcional Sistemi i listave	PO Modeli 4: Aleanca Popullore dhe Partia Social Demokrate kanë 40% kuota për femra.	31.7 (2007)
Gjermania	Përfaqësimi proporcional: sistemi i anëtarëve i përzier	PO Modeli 4: Partia e Socializmit Demokratik dhe të Gjelbrit kanë 50% kuota; Unioni Kristian Demokrat ka 33.3%; Partia Social Demokrate e Gjermanisë ka 40%.	31.6 (2005)
Burundi	Përfaqësimi proporcional	PO Modeli 4: Kuota Legjislative prej 30% të kandidateve femra	30.5 (2005)

Shënim 1: Konsiderohen modelet e më poshtme të kuotave:
 Modeli 1 = Kuota kushtetuese për parlamente nacionale
 Modeli 2 = Kuota bazuar në ligjin për zgjedhje ose rregullore për parlamentin nacional
 Modeli 3 = Kuota kushtetuese ose ligjore për qeveri lokale
 Modeli 4 = Kuota të partive politike për kandidatët për zgjedhje

Shënim 2: Viti i zgjedhjeve të fundit në parantëzë.

Katrori 3 OJQ-të e Kambogjës: promovimi i pjesëmarrjes së grave dhe bashkëpunimit ndër partiak.

Mungesa e bashkëpunimit ndër partiak në Kamboxhia dhe dominimi i një partie ka pasur pasoja negative për grupimin e grave në parti për qëllim të promovimit të çështjeve gjinore, posaçërisht në nivelin kombëtarë. Përkundër kësaj, gratë kamboxhiane që punojnë në OJQ janë në front të ndërtimit të urave përgjatë linjave partiake. Gratë për Prosperitet (GpP) është një nga organizatat më efektive në këtë sektor. E udhëhequr nga Pok Nanda (e kthyer) GpP ka qenë pionier i programit që jo vetëm se inkurajon dhe mundëson gratë të hyjnë në politikë por edhe ndërlihd ndarjet ndër partiake në nivelin komunal. Në rjetin e vet ka edhe anëtarë të këshillave të grave nga të gjitha anët, duke përfshirë tri partitë kryesore

politike. GpP përqendrohet në sfidat e përbashkëta me të cilat përballen gratë në politikë, pavarësisht nga ideologjia dhe ofron trajnim të vazhdueshëm, dukë ndërtuar kështu aftësitë e tyre me kalimin e kohës. Në përgatitje të zgjedhjeve për këshilla komunal në vitin 2000, GpP mbështetën 5,527 kandidatë duke ju ofruar udhëzime për fjalimet publike, duke i asistuar në shkrimin e fjalimeve, duke u përgjigjur në pyetjet e votuesve dhe duke i luftuar sfidat nga anëtarët meshkuj të partive, të cilët nuk janë simpatik ndaj pjesëmarrjes së grave. GpP ka farkëtuar baza të reja politike për pjesëmarrjen e grave si dhe ka ofruar modele efektive për bashkëpunimin ndër partiak.³⁵

ligji, u formua një koalicion ad hoc i organizatave të grave dhe të paqes dhe u iniciuan fushata mediale dhe lobime ekstensive.³⁶

Strategjitë në vijim mund të përdoren për të shtuar pjesëmarrjen e grave (dhe grupeve tjera më pak të përfaqësuar) brenda parlamentit dhe brenda komisioneve të mbrojtjes dhe sigurisë:

Shtimi i pjesëmarrjes së grave në parlament

- Të përcaktohen kuotat, qofshin ato në Kushtetutë, legjislacion të partive politike apo rregullore elektorale, me të cilat rezervohen vende për gra ë parlament.
- Të punohet me shoqërinë civile në zbatimin e programeve në nivel të parlamentit si dhe partive politike, për të inkurajuar dhe pajisur gratë për t'u kandiduar për poste (shih katrorin 3).
- T'u ofrohet stimulim partive politike në nominimin e grave për poste.
- Të krijohet komiteti drejtues i grave parlamentare në mënyrë që parlamentarët femra të mund të përkrahin njëra tjetrën dhe të bashkëpunojnë për politikën e promovimit të çështjeve gjinore; dhe/ ose të krijohet komiteti drejtues i meshkujve/ grave parlamentarë të përkushtuar ndaj avancimit të çështjeve gjinore (shih katrorin 5).
- Ndërmerr auditim të implikimeve gjinore të sistemit zgjedhor.
- Parlamentarët femra me përvojë mund të mentorjnë parlamentarët me më pak përvojë ose atyre me aspirata.

Shtimi i pjesëmarrjes së grave në komisionet parlamentare për siguri dhe mbrojtje dhe në vendimmarrjen e sigurisë

- Të miratohet legjislacioni i cili thërret për shtimin e grave në komisionet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë.
- Të merret në konsideratë krijimi i kuotave gjinore për të gjitha strukturat e komisioneve.
- Të kërkohen më shumë gra në pozita të larta ekzekutive, për shembull në kabinet dhe në këshillin nacional të sigurisë.

4.5 Zbatimi i prokurimit dhe buxhetimit të barabartë

Parlamentarët mund të zbatojnë iniciativë për buxhetimin e çështjeve gjinore për të forcuar përdorimin e barabartë dhe adekuat të fondeve. Buxhetimi i çështjeve gjinore është 'aplikim i përfshirjes së gjinisë në proceset buxhetore. Kjo nënkupton vlerësim të buxheteve të bazuara në çështje gjinore, duke inkorporuar perspektivën gjinore në të gjitha nivelet të procesit buxhetor dhe duke ristrukturuar kështu të hyrat dhe shpenzimet në mënyrë që të promovohet barazia gjinore.³⁷

Parlamenti mund të ofroj të dhëna për buxhetimin e lidhur me çështje të sigurisë në katër faza kryesore të ciklit tipik buxhetor:³⁸

- Përgatitja e buxhetit: kjo fazë është për ekzekutivin të propozoj alokimin e parave për disa qëllime, mirëpo parlamenti dhe anëtarët e tij mund të kontribuojnë në proces përmes mekanizmave të ndryshëm formal dhe joformal.
- Aprovimi i buxhetit: parlamenti duhet të jetë në

gjendje të studiojë dhe të përcaktoj interesin publik dhe përshtatshmërinë e alokimit të parave, si dhe mundet në kontekste të caktuara të plotësoj shumat e caktuara për çështjet e sigurisë me udhëzime të caktuara.

- Ekzekutimi dhe shpenzimet: parlamenti shqyrton dhe monitoron shpenzimet e qeverisë dhe mund të përpiket të forcojë transparencën dhe përgjegjësinë. Në rast të kërkesave ekstra buxhetore, parlamenti monitoron dhe vëzhgon këto kërkesa në mënyrë që të parandaloj tejkalimet e shpenzimeve.
- Auditimi dhe shqyrtimi: parlamenti vëzhgon nëse ka pas keqpërdorim të parave të alokuara nga qeveria. Po ashtu vlerëson në mënyrë periodike buxhetin në tërësi dhe auditon procesin për të siguruar përgjegjësi, efikasitet dhe saktësi.

Një nga mjetet që shpesh përdoret në buxhetimin e çështjeve gjinore është Deklarata Buxhetore për Vetëdijesimin e Çështjeve Gjinore. Kjo deklaratë mund të zhvillohet duke u bazuar në tërë buxhetin apo në aktorë specifik siç është siguria. Shpenzimet dhe të hyrat analizohen në afate në të cilat ka mundësi të ndikojnë më së shumti në grupe të ndryshme të grave dhe burrave, djemve dhe vajzave. Qëllimi është të sigurohet që nevojat e grave dhe burrave konsiderohen në mënyrë të barabartë.³⁹

Këshilli i Evropës shpjegon se parlamentet 'negociojnë, amendojnë dhe në fund miratojnë buxhetin e propozuar nga autoritetet ekzekutive, por ato mundën po ashtu të paraqesin kërkesa dhe të kyçen në aktivitete lobimi, duke participuar kështu në formimin e vullnetit politik dhe fuqizimit të qeverive.⁴⁰ Brenda qeverisë, iniciativat për buxhetim të çështjeve gjinore tërheqin vëmendjen tek çështja e barazisë gjinore në alokimin e resurseve. Për avokatët e shoqërisë civile dhe parlamentarët këto janë mjete të dobishme me të cilat apeloher për transparencë më të madhe të vendimeve buxhetore dhe përgjegjësi ndaj grave.⁴¹ Iniciativat e buxhetimit me aspekt gjinor synojnë të transferojnë vetë procesin buxhetore, duke shtuar kështu rolin e legjislaturës dhe shoqërisë civile.⁴²

Sistemet buxhetore të ndjeshme ndaj gjinisë janë në avokim e sipër dhe po zbatohen në një numër vendesh përreth botës. Për shembull, në Brazil, organizatat e shoqërisë civile punojnë me gratë parlamentare për të avokuar për buxhetet që i përgjigjen çështjeve gjinore.⁴³ Në Filipine, grupet e grave rrisin vetëdijesimin për rëndësinë e buxhetimit me aspekt gjinor dhe theksojnë rolin kyç që dispozitat legjislative luajnë në shtytjen për barazi gjinore.⁴⁴ Iniciativa Buxhetore e Grave të Afrikës së Jugut ishte rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të parlamentarëve dhe disa organizatave të shoqërisë civile. Iniciativa përqendrohet në dimensionet gjinore të tatimit dhe shpenzimeve dhe kërkon të siguroj

Katrori 4 Mjetet dhe metodat e parlamentit për buxhetimin me aspekt gjinor⁴⁶

Analizimi i shpenzimeve/të hyrave. Në mënyrë që të analizohen gjendjet aktuale të grave dhe burrave ose vajzave dhe djemve në sektorë specifik-ose të vlerësohen efektet gjinore të politikave ose masave të politikave-janë zhvilluar masa të mëtutjeshme të cilat e lidhin buxhetin me politikën, duke u përqendruar në aspekte të ndryshme (të hyrat, shpenzimet, shërbime publike ose shfrytëzimin e kohës).

Analizë e alokimeve të ardhurave bazuar në ndarje gjinore është teknikë hulumtimi e cila ekzaminon tatimet direkt dhe indirekte si dhe pagesat për përdorim të bëra nga gratë dhe burrat.

Analiza e shpenzimeve publike me ndarje gjinore krahason shpenzimet publike të një programi të caktuar, zakonisht me të dhëna nga anketat e ekonomisë shtëpiake, për të shpalosur kështu shpërndarjen e shpenzimeve mes grave dhe burrave apo vajzave dhe djemve.

Vlerësimi i përfitimeve të ndara në bazë gjinore është teknikë hulumtimi e përdorur për të pyetur përfituesit aktual

apo potencial masën deri ku programet qeveritare dhe/ose shërbimet publike i përshtaten nevojave të tyre, dëshirave dhe prioritetëve.

Vlerësimi i ndikimit të gjinisë është vlerësim ex post i buxheteve ose vlerësim ex ante i propozimeve buxhetore dhe ndoshta mjeti më ekstensiv dhe më kompleks i buxhetimit të çështjeve gjinore pasi që i referohet efekteve afat shkurtra dhe afat gjata të buxheteve në shpërndarjen dhe në qasjen në resurse (duke përfshirë kohën) dhe në rolet dhe normat e gjinisë.

Vlerësimi i politikave të vetëdijshme me çështje gjinore përfshin vëzhgimin e politikave të portofoleve dhe programeve të ndryshme dhe i kushton vëmendje të veçantë çështjeve gjinore implicite dhe eksplicite të involvuara. Kjo vë në pyetje supozimin se politikën janë 'neutrale ndaj gjinisë' në efektet e tyre dhe kërkon të zgjidh se në çfarë mënyre politikën dhe alokimet e tyre të resurseve mund të zvogëlojnë apo rrisin pabarazitë gjinore.

Katrori 5 Konstruksioni i aleancave

Është përgjegjësi e përbashkët e grave dhe burrave parlamentarë të integrojnë perspektivën gjinore në punën e tyre. Donna Pankhurst afirmon se 'shanset e suksesit shtohen në mënyrë të dukshme aty ku përgjegjësia për ndryshimin e kulturës së institucioneve nuk lihet tërësisht në duar të grave, por po ashtu bëhet përgjegjësi e burrave.⁴⁷ Për të qenë të suksesshëm në transformimin e parlamentit në institucion që i përgjigjet çështjeve gjinore, gratë dhe burrat duhet të ndajnë të kuptuarit e analizave gjinore.

Një transformim i tillë drejt barazisë gjinore është i mundshëm vetëm nëse burrat dhe gratë punojnë së bashku për të ndryshuar vetëdijen shoqërore. Si grup, burrat janë më të privilegjuar në hierarkitë aktuale të pushtetit dhe mund të pritët që ata ti rezistojnë ndryshimeve. Prandaj është veçanërisht e rëndësishme që burrave t'ju demonstron rëndësia e analizave gjinore. Prandaj është veçanërisht e rëndësishme t'ju demonstron burrave rëndësia e analizave gjinore. Parlamentarët përfitojnë duke aplikuar gjininë në punën e tyre pasi që analizat gjinore ju ndihmojnë atyre për t'i njohur më mirë nevojat e votuesve meshkuj dhe femra. Tsjard Bouda dhe Georg Frerks theksojnë se 'politikën e ndryshme gjinore kërkojnë analiza të thukta gjinore të cilat sqarojnë ndërlidhjen mes gjinisë, situatave të veçanta të

konfliktit dhe ndikimin e ndryshëm potencial të intervenimeve të jashtme në gra dhe bura.⁴⁸ Për shembull, analizat gjinore sjellin përpara mënyrat e ndryshme sipas të cilave gratë dhe burrat i ekspozohen dhunës seksuale gjatë konfliktit të armatosur ose theksojnë nevojat e ndryshme të re integrimit të vajzave dhe djemve të cilët janë kidnapuar dhe detyruar të shërbejnë në lëvizjet e armatosura që veprojnë në Afrikë, Azi dhe Amerikë Latine.

Një shembull i suksesshëm i parlamentarëve femra dhe gra të cilët i bashkojnë forcat për të forcuar barazinë gjinore është Grupi Parlamentar i Mbretërisë së bashkuar për Gra, Paqe dhe Siguri. Ky grup u organizua rreth zbatimit efektiv të Rezolutës së Kombeve të Bashkuara 1325. Komisioni , i udhëhequr nga parlamentari i Partisë Laburistë, Joan Ruddock përbëhet nga gjashtëmbëdhjetë gra dhe gjashtë burra. Përbërja gjinore dhe fokusi substancial i grupit qëndron jashtë duke marrë parasysh përbërjen tradicionale të komisioneve Britaneze, duke përfshirë ato për siguri. Për dallim, Komisioni i Përbashkët për Mbrojtje të Parlamentit Britanez ka vetëm një anëtar femër nga 15 anëtarë sa ka në tërësi. Ngjashëm, Komisioni për Mbrojtje të emëruar nga Dhoma e Ulwt, përmban vetëm një femër parlamentare.

që procesi buxhetor është konform me parimin e barazisë gjinore. Kjo përpjekje është participatore, dhe përfshin diskutime në nivel nacional dhe lokal të qeverisë dhe kërkon të dhëna nga qytetarët. Grupet e shoqërisë civile ishin të mandatuara të analizojnë buxhetin dhe politikën prapa tij, për ndikimin e tyre në gjini, ndërsa parlamentarët përdorën rezultatet e hulumtimit në përpjekjet e tyre për të formësuar debatet e buxhetit në parlament.⁴⁵

Strategjitë për buxhetim dhe prokurim më të barabartë përfshijnë:

Buxhetimi me aspekt gjinor

- Ndërmerr auditim me aspekt gjinor të të gjitha buxheteve ekzistuese dhe atyre të propozuara për të siguruar fonde për të adresuar nevojat e sigurisë për gra, burra, djem dhe vajza.
- Përfshij çështjet gjinore në buxhetet e propozuara.

Prokurimi me aspekt gjinor dhe të mbrojtjes

- Siguro që të rezervohen fonde për t'u shpenzuar në uniforma dhe pajisje për gra, lehtësi të veçanta për gra dhe nevojat e grave për shëndet riproduktiv.
- Siguro që rregulloret nacionale për tregti me armë të ndalojnë tregtinë me regjime ose individ që kryejnë GBV.

5 Integrimi i gjinisë në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë në kontekste specifike

5.1 Vendet post-konflikte

Shoqëritë e dëmtuara nga lufta përballen me sfida specifike kur trajtojnë nevojat e sigurisë për popullatën e tyre. Parlamentarët mund të luajnë rol konstruktiv për të siguruar që çështjet gjinore janë të integruara në dispozitat që kanë të bëjnë me sigurinë në proceset e paqes siç është çarmatimi, demobilizimi dhe reintegrimi (DDR) dhe në mekanizmat e drejtësisë në tranzicion dhe se këto merren parasysh kur adresohet dhuna dhe krimi në pas konflikt. Kontekstet pas konflikti paraqesin mundësi për të shtuar numrin e grave parlamentare si pjesë të reformës politike dhe elektorale.

Përveç që merren me krime të kryera gjatë luftës, parlamentet mund të marrin iniciativa për adresimin e ambientit të sigurisë i cili shfaqet pas konfliktit. Dhuna pas luftës, pavarësisht a është kryer në sferën publike apo private i prek shumë vende.

Parlamentet mund të adresojnë çështje shoqërore të sigurisë përmes reformës së forcave policore dhe ushtarake, gjyqësisë dhe burgjeve si dhe duke miratuar legjislacionin i cili e trajton krimin në mënyrë më të mirë.

Proceset paqësore

Idealisht, parlamentet luajnë rol në parandalimin e konfliktit ose sigurisë preventive. Në qoftë se konflikti veç ka shpërthyer, parlamenti megjithatë mund të luajë rol konstruktiv në negociatat paqësore dhe marrëveshjet e paqes. Këto marrëveshje të paqes shpesh shërbejnë si kornizë për reformën në sektorin e sigurisë dhe prandaj integrimi i çështjeve gjinore në fazë të hershme është i nevojshëm. Parlamentarët mund të kyçen drejtpërdrejt në proceset negociatore dhe përbëjnë forum të rëndësishëm për ngritjen e vetëdijes publike për proceset formale dhe joformale të paqes të cilat zhvillohen në vendet e tyre.

Për shembull, parlamentarët mund të jenë avokatë të procesit negociator i cili inkorporon gratë në tërësi. Në rastet kur vetë parlamenti ka vend në tryezën e paqes, gratë legjislatorë duhet të përfshihen në delegacion. Një përbërje më e balancuar e ekipeve negociatore jep sinjal të rëndësishëm se dimensionet gjinore të konfliktit do të merren për bazë gjatë procesit të negociatave dhe bën më të mundur që perspektiva gjinore informon marrëveshjet e paqes dhe ato të sigurisë. Parlamentarët kanë përparësi të dukshme sepse ata mund të ndalin aprovimin e marrëveshjeve të cilat nuk bazohen në përfshirjen e gjinisë dhe përmes kësaj në procesin legjitim. Parlamenti i cili thekson dimensionet gjinore të zgjidhjes së konflikteve përkrahet nga një konsensus ndërkombëtar sipas të cilit çfarëdo procesi i paqes i cili 'dështon t'i përfshijë gratë në përcaktimin e agjendës, bisedave substancive dhe në zbatim nuk ka legjitimitet demokratik.⁴⁹

Kur gratë janë të përjashtuara, ekziston një

tendencë natyrore për tu përqendruar në përvojat e meshkujve në konflikt dhe pritet e tyre për zgjidhjen e konfliktit, në vend se të konsiderohen nevojat e aktorëve meshkuj dhe femra si dhe pozitat e tyre respektive në strukturat shoqërore.⁵⁰ Pjesëmarrja e grave e pasuron procesin, pasi që gratë është më se e mundshme të japin kontribut ndryshe në procesin e paqes. Kur krahasohen me burra, gratë është më se e dukshme se do t'i qesin çështjet gjinore në agjendë, të prezantojnë përvojat tjera të konfliktit, dhe të përcaktojnë prioritetet tjera për ndërtimin e paqes dhe rehabilitimin, si dhe mund t'i bashkojnë dallimet politike më mirë.⁵¹

Në vendet post konflikti, faza zbatuese e marrëveshjeve paqësore kërkon vëmendje të posaçme të parlamentit. Marrëveshjet e paqes dhe ndërtimi kushtetutës paraqet mundësi të rëndësishme për vendet që dalin nga konflikti në transformimin e sistemeve të tyre politike drejt një barazie më të madhe gjinore. Parlamenti mund të monitorojë negociatat zyrtare paqësore dhe të ngrejë zërin për iniciativa joformale që vijnë nga shoqëria civile.

Çarmatimi, demobilizimi dhe reintegrimi

Zgjidhja e konfliktit të dhunshëm nënkupton çarmatim dhe demobilizim të dhunshëm të forcave ndërluftuese. Një proces DDR efektiv e njeh faktin që gratë dhe burrat preken ndryshe nga lufta dhe kujdeset për nevojat e ish luftëtarëve meshkuj dhe femra si dhe grave dhe fëmijëve të asociuara me forcat e armatosura dhe grupet luftuese. Parlamentet mund të luajnë rol konstruktiv si avokat për procesin DDR që i përgjigjet çështjeve gjinore (shih katrorin 6). Nevojat e grave dhe vajzave të cilët janë pjesë ose asociohen me forca të armatosura ilegale, shumë shpesh anashkalohen nga procesi DDR. Aspektet tjera gjinore përfshijnë këshillimin, edukimin dhe reintegrimin efektiv të ish luftëtarëve meshkuj, me qëllim që të zbusin rrezikun që të bëhen shkelës të

Katrori 6

Transformimi i procesit DDR: roli i parlamenteve⁵⁸

Funksionet legjislative dhe të mbikëqyrjes të parlamenteve ju ofrojnë atyre rol të rëndësishëm institucional në garantimin që gjinia do të merret parasysh në mënyrë adekuate në procesin e DDR. Parlamentarët mund të sigurojnë që nevojat e luftëtarëve meshkuj dhe femra merren parasysh qysh në fillim. Vëmendje e veçantë duhet të kihet që të sigurohet që vetë procesi i çarmatimit ka parasysh ndjeshmërinë e çështjeve gjinore. Në Ugandë, parlamenti ka marrë rol aktiv në vizitat e

kampeve të demobilizimit për të hetuar kushtet e luftëtarëve femra dhe meshkuj. Si rrjedhojë e kësaj ka kërkuar veprime nga qeveria. Në Amerikën Latine, ligjvënësit Kolumbian po marrin interes të shtuar në çështjet e demobilizimit me të cilat përballen votuesit e tyre. Në mënyrë që të marrin rol konstruktiv në demobilizimin e luftëtarëve, parlamentarët duhet të kuptojnë rolin kompleks të grave dhe burrave në luftë si dhe nevojat e tyre gjinore në paqe.

Katrori 7 | Komision i Afrikës së Jugut për të Vërtetën dhe Pajtimin: integrimi i çështjeve gjinore

Përvoja e Afrikës së Jugut paraqet rastin e përfshirjes së suksesshëm parlamentare në prezantimin e dimensionit gjinor në krijimin e komisionit për të vërtetën dhe pajtimin. Anëtarët e Parlamentit të Afrikës së Jugut të cilët paraqesin partitë politike të vendit së bashku me liderët e organizatave të shoqërisë civile formuan një komision seleksionues i cili luajti rol kyç në përcaktimin e përbërjes së komisionit për të vërtetën. Duke u bazuar në 300 nominime të pranuar nga procesi publik, komiteti seleksionues krijoi një listë prej 25 finalistëve.⁵⁹ Presidenti Nelson Mandela zgjodhi 15 komisionar nga kjo listë. Një e treta e tyre ishin gra.⁶⁰ Kjo kuotë reflekton përkushtimin e Kongresit Nacional të Afrikës për t'i alokuar grave një të tretën e pozitave vendimmarrëse. Përkushtimi për të forcuar barazinë gjinore rezultoi në një balanc gjinor

më të përmirësuar në parlament ku gratë mbajnë gati 33% të ulëseve në vitin 2006.

Përkundër përfshirjes së dukshme të grave në komision, u bë pjesë e hetimeve të tij kur organizatat e grave denoncuan se burrat kishin qasje më të privilegjuar dhe se përvojat e grave ishin marginalizuar. Gratë ishin më pak të gatshme për të diskutuar dhunën dhe incidentet tjera të dhunës seksuale përpara anëtarëve meshkuj të komisionit. Lëvizja e grave e shtyu në mënyrë të suksesshme përfshirjen e çështjeve gjinore në agjendën e komisionit.⁶¹ Në përpjekje për të qenë më të ndjeshëm ndaj nevojave të grave, të gjithë komisionarët morën trajnim në çështjet gjinore dhe komisioni pat disa seanca të veçanta të grave.⁶²

dhunës familjare apo formave tjera të dhunës në jetët e tyre pas konfliktit.

Ristrukturimi i sektorit të sigurisë pas konfliktit është mundësi e rëndësishme për parlamentin të krijoj forca reprezentative të sigurisë. Menjëherë pas konflikti vendet si El Salvador, Guatemala, Mozambiku ose Liberia integruan ish luftëtarët e vet në forca të krijuara të policisë dhe ushtrisë. Të dhënat e demobilizimit të mbledhura nga misionet paqësore të KB përreth botës tregojnë se gratë përbëjnë deri 30% të luftëtarëve të shumë forcave kryengritëse. Prandaj ekziston një grup rekrutues i cili lejon transformimin e forcave tradicionale të policisë dhe ushtrisë në një përbërje më të balancuar gjinore.

Shih mjetin për Reformën e Mbrojtjes dhe Gjinisë

Gjyqësia në tranzicion

Parlamentarët luajnë rol të rëndësishëm në sigurimin që konsideratave gjinore u jepet më shumë peshë në administrimin e drejtësisë pas konfliktit. Përgjegjësia publike për krimet e kryera gjatë konfliktit duke përfshirë ato të bazuara në gjini, është esenciale për rindërtimin e suksesshëm të shoqërisë. Përderisa gratë duket të jenë përfituesit më të mëdhenj të iniciativave gjinore të drejtësisë, vështrimi gjinor po ashtu ndihmon në njohjen më të mirë të viktimave meshkuj të dhunës. Funksonet legjislative dhe mbikëqyrëse të parlamentit së bashku me autoritetin buxhetor u japin parlamentarëve mundësinë që të merren me çështjet e drejtësisë pas konfliktit.

Parlamenti mund të jetë vendi për debate publike mbi çështjet përçarëse pas konfliktit dhe të luajnë rol udhëheqës në promovimin e tolerancës.⁵²

Parlamentet ndajnë përgjegjësinë në krijimin e organeve fakt mbledhëse, si për shembull komisionet e së vërtetës të cilat krijojnë dosje të krimeve të kryera gjatë luftës. Ato po ashtu marrin pjesë në krijimin e gjykatave speciale për përndjekjen e fajtorëve. Parlamentet mund të kërkojnë që përbërja gjinore e këtyre organeve të jetë e barabartë dhe që perspektiva gjinore të merret parasysh në punimet dhe politikat e tyre. Parlamentet kanë kontroll domethënës mbi punën e këtyre komisioneve, pasi që ato kalojnë legjislacion, marrin pjesë në emërimin e komisionerëve individual, alokojnë fonde operationale dhe mbikëqyrin zbatimin e konkludimeve të komisionit.⁵³

Gjatë 30 viteve të kaluara, shumë komisione fakt mbledhëse janë themeluar në nivel ndërkombëtarë dhe nacional të cilat hetojnë abuzimet e të drejtave të njeriut që kanë ndodhur gjatë konfliktit.⁵⁴ Gratë kanë kryesuar dy nga komisionet, Komisionin Ndërkombëtarë të KB për Hetime, i cili heton shkeljet e të Drejtës ndërkombëtare Humanitare ne Timorin Lindor, dhe Komisioni i Shri Lankës për Provincat Perëndimore dhe Jugore.⁵⁵

Parlamentet munden po ashtu të sigurojnë qasje të barabartë në punimet e komisioneve të së vërtetës dhe atyre të pajtimit duke qenë të ndjeshëm ndaj nevojave specifike të viktimave meshkuj dhe femra (shih katrorin 7). Për shembull, ligjvënësit mund të insistojnë që disa seanca t'i dedikohen ekskluzivisht dëgjimeve të dëshmimeve nga viktimat femra dhe/ose që një kapitull i raportit të komisionit t'i dedikohet

GBV. Krahasuar me viktimat meshkuj, gratë që kanë qenë viktime është më pak e mundshme të kenë qasje në proceset e drejtësisë sepse ato shpesh janë ekonomikisht më të dobëta dhe kanë më shumë detyra familjare të cilat e kufizojnë gatishmërinë e tyre.⁵⁶ Parlamentet mund po ashtu të vendosin kompensimin për viktime agjendën nacionale. Një gjë të tillë ja arriti ta bënte parlamenti i Bregut të Fildishtë kur ekzekutivi dështoi të vepronte.⁵⁷ Një grup i ligjvënësve shërbyen si avokatë të viktimave dhe i lobuan parlamentit që të veproj. Skemat e kompensimit duhet po ashtu të jenë të dizajnuara në mënyrë që të përfshijnë çështjet gjinore, duke i njohur abuzimet e caktuara me të cilat janë përballë burrat dhe gratë gjatë konfliktit, si dhe nevojat e tyre të dalluara për riparim.

Shih Mjetin mbi Reformën në Drejtësi dhe Çështjet Gjinore

Dhuna dhe krimet në vendet e post-konfliktit

Edhe pse krimet e bazuara në gjini të kryera gjatë luftës janë njohur si krime të luftës, pak vëmendje i është kushtuar mënyrës në të cilën ndikojnë rrethanat e lidhura me konfliktin në vazhdimin e dhunës brenda vendit menjëherë pas përfundimit të armiqësisë.⁶³ Të kuptuarit e çështjeve gjinore mund t'i ndihmoj parlamentarët të jenë mirënjohës ndaj rëndësisë së trajtimit të dhunës familjare dhe stresit të pas konfliktit, me të cilën janë përballë ish luftëtarët dhe të zhvendosurit. Studimet e KB kanë gjetur shtim dramatik të dhunës familjare në vendet pas konfliktit, të ndezur nga prezenca e armëve, dhuna me të cilën janë përballë anëtarët meshkuj të familjes, mungesa e vendeve të punës, strehimit dhe shërbimeve themelore. Personat e zhvendosur janë

Tabela 3

Inicimi i ndryshimeve në periudhën e pas luftës: përbërja gjinore e parlamenteve të pas luftës⁶⁹

Vendi	% e Grave	% e Burrave
Ruanda (2003)	48.8	52.2
Mozambiku (2004)	34.8	65.2
Afrika Jugore (2004)	32.8	67.2
Burundi (2005)	30.5	69.5
Uganda (2006)	29.8	70.2
Timor-Leste (2007)	27.7	72.3
Afganistan (2005)	27.3	72.7
Irak (2005)	25.5	74.5

në veçanti në pozitë më të dobët.⁶⁴

Amerika Qendrore post-konflikti ofron shembull të transformimit të dhunës së lidhur me luftën në një valë krimesh të cilat e prekin edhe sferën publike edhe atë private.⁶⁵ Përderisa dhuna politike u qetësua pas marrëveshjeve të paqes, dhuna kriminale u ngrit. Në masë të shtuar, gratë u bënë viktime. Guatemala regjistroi vrasjen e 383 grave në vitin 2003, një rritje prej 135% krahasuar me 2002. Në vitin 2004, u vranë 527 gra. Gjatë tetë muajve të parë të vitit 2005 numri i vdekjeve ishte 427, gjë që tregon se shkalla e vrasjeve vazhdoi të rritet.⁶⁶ Përderisa dhuna e drejtuar kundër grave është pjesë e valës së përgjithshme të krimeve që prekin vendin, shkalla në të cilën vriten gratë e len pas atë të burrave.

Edhe pse gratë vuajnë në masë të madhe në kushte të dhunës pas konfliktit, është me rëndësi të dihet se dhuna e cila dominon në shoqëritë e dëmtuara nga lufta prek burrat në numër joproporcional. Në Kolumbi, një çerek e të gjitha vdekjeve të meshkujve i atribuohen dhunës, sikur që 60% e vdekjeve të burrave janë mes moshës 15 dhe 44 vjeçare.⁶⁷ Për

Katrori 8

Implementimi i kuotave kushtetuese: reformat në Afganistan dhe Irak⁷³

Afganistani ka ndryshuar nga një vend ku të drejtat e grave ishin të kufizuara ashpërsisht në një vend që garanton barazi gjinore me ligj. Në sferën e përfaqësimit politik, kushtetuta e re garanton përfshirje formale të grave në procesin e vendim-marrjes politike. Neni 83 deklaron që së paku dy kandidatet femra duhet të zgjedhën nga çdo provincë në parlament. Ky provizion kushtetues ishte zbatuar në mënyrë të suksesshme. Në zgjedhjet e shtatorit të vitit 2005, 69 gra, që përfaqësonin pothuajse 27% nga 249 anëtarë të Wolesi Jirga, u zgjedhën.

Në mënyrë të njëjtë, kushtetuta e re e Irakut, e ratifikuar në tetor të vitit 2005, garanton grave një çerek të 275 ulëseve të parlamentit. Në Irak gjithashtu, kuota kushtetuese ishte vendosur. Pas zgjedhjeve të dhjetorit të vitit 2005, gratë përfaqësojnë një çerek të Përfaqësuesve të Këshillit Nacional. Këto dy rezultate të zgjedhjeve janë shumë të rëndësishme së veçantë në një regjion ku gratë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuar në vendim-marrjen politike dhe, në disa raste, u mungon drejta e plotë qytetare.

burrat Kolumbian mundësitë janë katër herë më shumë të vdesin nga vdekja e dhunshme sesa femrat.⁶⁸ Në përgjithësi burrat përbëjnë shumicën e viktimave të dhunës së armëve dhe asaj gangsterë, duke qene në të njëjtën kohë edhe kryes të dhunës.

Parlamentarët në Amerikën Qendrore dhe rajonet tjera të botës janë në masë të madhe të shqetësuar për shtimin e armëve të vogla, të cilat përdoren në shumicën e këtyre vrasjeve. Kohët e fundit, anëtarët e Kongresit të Guatemalës mandatuan dhe drejtuan një studim mbi sëmundjen e keqe të 'femicide-vrasjet e femrave' në Guatemala. Ky studim është prezantuar në një numër takimesh publike duke theksuar problemin e dhunës së armatosur të burrave dhe viktimave të tyre.

Parlamentet reprezentative

Konteksti pas konfliktit ngërthen në vete edhe premtimin e transformimit të vet parlamentit. I ofron ligjvënësve mundësin të ndryshojnë përbërjen e vet dhe të bëhen me të vërtetë organe reprezentative (shih Tabelën 3). Transformimi i parlamentit drejt një përbërje gjinore më të barabartë është tregues i rëndësishëm se barazia gjinore është prioritet në ri ndërtimin e shoqërisë.

Fokusi ndërkombëtarë në shtimin e rolit të grave në vendim marrje ka shërbyer si stimulim për qeveritë në shoqëritë e prekura nga konflikti për forcimin e barazisë gjinore të parlamenteve të tyre. Në përgjithësi kjo është arritur me ndihmën e kuotave legjislative dhe kushtetuese. Afganistani dhe Iraku paraqesin shembujt e fundit më të suksesshëm të zbatimit të kuotave kushtetuese (shih katrorin 8).

5.2 Vendet e Zhvilluara

Parlamentet në shoqëritë e zhvilluara ballafaqohen me të njëjtat sfida të brendshme për sa i përket reformës së sektorit të sigurisë si homologet e tyre në botën në zhvillim, mirëpo nga një pozicion tjetër. Për shembull, parlamentet Evropiane dhe të Amerikës Veriore duhet të këmbëngulin në autoritetin e tyre në mbikëqyrjen e misioneve paqësore ose intervenimeve ushtarake. Misionet e NATO-së në Afganistan dhe Ballkan, intervenimi humanitar i udhëhequr nga KB në Haiti janë disa nga shembujt e fundit. Marrëveshjet ndërkombëtare dhe rajonale të bashkëpunimit paraqesin sfida ndaj mbikëqyrjes efektive parlamentare. Në të gjitha instancat, parlamentet duhet të sigurojnë që politika e sigurisë zbatohet në mënyrë që është konsistente me të Drejtën dhe parimet ndërkombëtare Humanitare.⁷⁰

Instrumentet ndërkombëtare –sidomos Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1325 –e cila mandaton konsideratë përkatëse ndaj çështjeve gjinore në të gjitha operacionet e paqes dhe sigurisë, janë veçanërisht relevante.

Disa vende kanë përdorur Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1325 si pikënisje të rëndësishme për reforma dhe kanë zhvilluar Plane nacionale të Veprimit për implementimin e saj ose janë në proces e sipër për ta bërë këtë. Në të shumtën e rasteve planet i referohen adresimit të çështjeve gjinore në sektorin e sigurisë të vendit dhe aspekteve gjinore të paqeruajtës dhe rindërtimit në vendet e pas konfliktit (në disa raste përfshihet edhe reforma e sektorit të sigurisë). Austria, Danimarka, Norvegjia, Suedia, Zvicra dhe Mbretëria e Bashkuar, të gjitha kanë zhvilluar Plane të Veprimit për 1325, ndërsa Kanada është në proces të zhvillimit të një plani të tillë.

Fokusi qendror i planit Suedez, i iniciuar në vitin 2006 ka të bëjë me operacionet paqeruajtëse. Plani i drejton forcat e armatosura të zhvillojnë 'përpjekje të ndërgjegjshme në shtimin e numrit të rekrutëve dhe oficerëve gra të cilët mund të marrin pjesë në operacionet paqeruajtëse' dhe krijon projekte siç është Forca Gjinore në mënyrë që të zhvilloj masa për 'përfshirjen e perspektivës gjinore në operacionet ndërkombëtare'. Ngjashëm me këtë, Bordi Nacional i Policisë 'zbatoi përpjekje të speciale për të shtuar proporcionin e grave në kontingjentet Suedeze të operacioneve për mbështetje të paqes.⁷¹ Për më tepër, të gjithë anëtarët e operacioneve paqeruajtëse duhet të trajtohen për çështje gjinore.

Parlamentarët e ndajnë përgjegjësinë për zhvillimin e planeve nacionale të veprimit. Përpjekjet për të zhvilluar planin Kanadez theksojnë rëndësinë e parlamentarëve në mbështetjen dhe lëvizjen e përpjekjeve për të zhvilluar planin duke kërkuar kështu nga Komisioni për Tregti Ndërkombëtare dhe Punë të Jashtme dhe Grupi Parlamentar i Grave të 'interesohen për këtë dosje dhe të luajnë rol në zbatim.⁷²

6 Rekomandime kryesore për parlamentarët

1. Të mbështesin nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e traktateve dhe konventave ndërkombëtare që përfshijnë çështjeve gjinore në reformën e sektorit të sigurisë, siç janë Konventa për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Femrave (CEDAW).
2. Të rrisin përfaqësimin e femrave parlamentare përmes zbatimit të kuotave, reformimit të sistemeve zgjedhore dhe duke mbështetur ngritjen e kapaciteteve në mesin e kandidatëve femrave.
3. Të rrisin përfaqësimin e femrave parlamentare në komisionet që kanë të bëjnë me mbrojtje dhe siguri, duke përfshirë edhe nxjerrjen e ligjeve për barazinë në përfaqësim të meshkujve dhe femrave apo të sistemit të kuotave parlamentare.
4. Të ndërtojnë kapacitete gjinore të parlamentarëve meshkuj dhe femra, veçanërisht të anëtarëve të komisioneve për mbrojtjen, sigurinë, përmes briefingjeve, trajnimeve dhe nismave të tjera të ngritjes së vetëdijes.
5. Përfshirja e shoqërisë civile, veçanërisht organizatat e femrave, në bërjen e politikave përmes konsultimeve të gjëra, dëgjimeve publike dhe mekanizmave të tjerë jo-formalë.
6. Të themelojë një grup të takimeve gjinore që do të përfshinte femra dhe meshkuj në mënyrë që të vetëdijësojë, dhe mbështet çështjet gjinore përkitazi me buxhetin dhe legjislacionin.
7. Të prezantojë dhe forcojë nismat buxhetore gjinore dhe të kryejë vlerësimet e ndikimit gjinor në politikat e sigurisë.
8. Të kërkojë dhe të sigurojë të dhëna të ndara gjinore përkitazi me theksimin dhe me hartimin e institucioneve të sektorit të sigurisë që politikbërësit të jenë në gjendje të jenë sa më të informuar gjatë marrjes së vendimeve.
9. Të monitorojë zbatimin dhe zbatimin e misioneve paqeruajtëse, të sigurojë që femrat janë mirë të përfaqësuara në forcat paqeruajtëse dhe të sigurojë që nismat janë marrë që të parandalojnë shfrytëzimin seksual

dhe abuzimin, dhe të ndërtojë kapacitete për stafin paqeruajtës që të integrohet në çështjet gjinore.

Veçanërisht në kontekstin post-konfliktuoz:

10. Të shfrytëzojë Kuvendin si një forum për të integruar çështjet gjinore dhe të sigurojë pjesëmarrjen e femrave në procesin e paqes.
11. Të kërkojë që femrat të jenë të përfshira tërësisht në çështjet gjinore dhe të inkorporohen në Komisionet për të vërtetën, Gjykatat speciale dhe programet për kompensim/përmirësim, edhe përmes legjislacionit që e mbështet krijimin e tyre.
12. Të reformojë sistemin gjyqësor, që të luftojë në mënyrë më të efektshme dhunën në baza gjinore.

7 Burime plotësuese

Shoqata e Parlamentarëve për Afrikën:

<http://www.awepa.org>

Unë e njoh politikën - <http://www.iknowpolitics.org>

Nisma për Siguri Gjithëpërfshirëse -

<http://www.womenwagingpeace.net>

Qendra Ndërkombëtare e Hulumtimit Zhvillimor -

<http://www.idrc.ca>

Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Ndihmë Zgjedhore - <http://www.idea.int>

Bashkimi Ndër-Parlamentar – <http://www.ipu.org>

UNDP, 'Në fokus: Kuvendet dhe

Theksimi Gjinator' –

http://www.undp.org.vn/projects/vie02007/in_focus/gender.html

UNIFEM -

<http://www.unifem.org/www/genderbudgets/work/html>

Udhëzime praktike dhe Libërtha

Byanyima, W. dhe Wehner, J., Kuvendi, *Buxheti dhe Gjinia*, IPU Libërthi, 2004.

http://www.ipu.org/PDF/publications/budget_en.pdf

Born, H., Fluri, P. Dhe Johnson, A. Eds., *Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë: Parimet, mekanizmat dhe praktikat*, DCAF ad IPU, 2003.

<http://dcaf.devisn.ch/publications/kms/details.cfm?lng=en&id=25289&nav1=4>

Freeman, M., *Duke e bërë pajtimin të funksionojë: Roli i Kuvendeve*, IPU Libërthi, 2005.

http://www.ipu.org/PDF/publications/reconciliation_en.pdf

Artikuj dhe Raporte on-line

Luciak, I.A., *Konflikti dhe Një Përgjigje Parlamentare Gjimore*, Prill 2006.

<http://www.parlcp.undp.org/docs/conference/Luciak.pdf>

O'Brien, M., *Raporti për Konferencën e Uillon Parkut WP784: Promovimi i Qeverisjës së Mirë dhe Zhvillimi në Vendet Pas-Konfliktuale: Roli i Kuvendit dhe i Qeverisë*, 2005.

http://www.iraqitradeunions.org/archives/cat_activities_abroad.html

Libra dhe publikimet të tjera jo-online

IPU/Instituti për Demokraci dhe Ndihmë Zgjedhore, *Duke e bërë pajtimin të funksionojë: Roli i Kuvendeve*, 2005.

Anderlini, S.N., *Femrat në Tavinën e Paqes: Duke bërë ndryshimin*, Nju Jork: UNIFEM, 2000.

Instituti i Bankës Botërore dhe Shoqata Parlamentare e Komonwelthit, *Kuvendetsi Paçebërës. Roli i Kuvendeve në Vendete Vendeve të prekura nga konfliktet*. Banka Ndërkombëtare e Rindërtimit dhe Zhvillimit/Banka Botërore, 2005.

ENDNOTES

- ¹ Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces (DCAF) and Inter Parliamentary Union (IPU), *Parliamentary Oversight of the Security Sector: Principles, Mechanisms and Practices*, (DCAF and IPU: Geneva), 2003, p. 22.
- ² DCAF and IPU, *'Parliamentary Oversight of the Security Sector: Principles, Mechanisms and Practices'*, (DCAF and IPU: Geneva), 2003.
- ³ Saalfeld, T., 'Members of Parliament and Governments in Western Europe: Agency Relations and Problems of Oversight', *European Journal of Political Research* 37 (2000), p. 372.
- ³ UN Economic and Social Council, *Report of the Secretary General, Coordination of the Policies and Activities of the Specialized Agencies and Other Bodies of the United Nations System: Mainstreaming the Gender Perspective into all Policies and Programmes in the United Nations system*, 12 June 1997.
- ⁴ Anderlini, S.N. and Conaway, C.P., *Negotiating the Transition to Democracy and Reforming the Security Sector: The Vital Contributions of South African Women*, (Initiative for Inclusive Security, Washington DC), 2004, pp. 17-18; 23-25.
- ⁵ IPU, as of 31 Aug. 2007. <http://www.ipu.org/wmne/classif.htm>
- ⁷ Luciak, I., *Conflict and a Gendered Parliamentary Response*, p.39; AWEPA, *The Role of Parliaments in Conflict Management and Peacebuilding*, Sept. 2006, p.66; Powley, E., *Rwanda: The Impact of Women Legislators on Policy Outcomes Affecting Children and Families*, UNICEF, Dec. 2006, p. 11.
- ⁸ *Report of the Learning Oriented Assessment of Gender Mainstreaming and Women's Empowerment Strategies in Rwanda*, 212 Sept. 2002, (UNIFEM, New York) 2003, cited by Anderlini, S.N. and ElBushra, J. in 'PostConflict Reconstruction' in *Inclusive Security, Sustainable Peace: A Toolkit for Advocacy and Action*, International Alert and Initiative for Inclusive Security, 2004, p. 64.
- ⁹ Werczberger, R., 'The Advancement of the Status of Women in Israel', 2001. http://www.jewishvirtuallibrary.org/jsources/Society_&_Culture/women2001.html
- ¹⁰ For this point see recent reports from the UN Department of Peacekeeping Operations. For national level recognition, see for example, 'The Swedish Government's action plan to implement Security Council Resolution 1325 on Women, Peace and Security'.
- ¹¹ DCAF and IPU, *Parliamentary Oversight of the Security Sector: Principles, Mechanisms and Practices*, (DCAF and IPU: Geneva), 2003, p. 130.
- ¹² IPU, 'The Participation of Women and Men in Decision Making: The Parliamentary Dimension', Background paper, The Expert Group Meeting on 'Equal Participation of Women and Men in Decisionmaking Processes, with Particular Emphasis on Political Participation and Leadership', Addis Ababa, Ethiopia, 24-27 Oct. 2005, p. 6.
- ¹³ IPU/UNDP/World Bank Institute/UNIFEM, *Parliament, the Budget and Gender*, p. 69.
- ¹⁴ Council of Europe, *Gender Budgeting* (Council of Europe: Strasbourg), 2005, pp. 28-36.
- ¹⁵ IPU, 'The Participation of Women and Men in Decision Making: The Parliamentary Dimension', p. 2.
- ¹⁶ IPU, Aug. 2007.
- ¹⁷ IPU reported in IPU and DCAF, *Parliamentary Oversight of the Security Sector*, 1997, p. 46.
- ¹⁸ Anderlini, S.N. and Conaway, C.P., 'Security Sector Reform', *Inclusive Security, Sustainable Peace: A Toolkit for Advocacy and Action*, International Alert and Women Waging Peace, 2004, pp. 35-36.
- ¹⁹ Melander, E., 'Gender Equality and Intrastate Armed Conflict', *International Studies Quarterly*, 49.4 (2005), p. 706.
- ²⁰ O'Brien, M., 'Parliaments as Peacebuilders: The Role of Parliaments in Conflict Affected Countries', Working Papers, Series on Contemporary Issues in Parliamentary Development, World Bank Institute and Commonwealth Parliamentary Association, (World Bank: Washington DC), 2005, p. 1.
- ²¹ UNDP/IPU, 'Global Study Group Meeting: Strengthening the Role of Parliaments in Conflict and PostConflict Situations, Final Draft Report', (IPU: Geneva), 20-22 July 2005, p. 14.
- ²² UNDP/IPU, 'Global Study Group Meeting: Strengthening the Role of Parliaments in Conflict and PostConflict Situations, Final Draft Report', (IPU: Geneva), 20-22 July 2005, p. 12.
- ²³ Van Brabant, K., 'Strengthening Parliaments in Conflict and PostConflict Situations: Drawing on Select Experiences from Africa', Draft prepared for the UNDP/UIP Global Study Group Meeting on Strengthening the Role of Parliaments in Conflict and PostConflict Situations, Geneva, 20-22 July 2005 (unpublished), p. 24.
- ²⁴ Human Rights Watch, 'Struggling To Survive: Barriers to Justice for Rape Victims in Rwanda', *Human Rights Watch Reports* 16:10(A)(2004). <http://hrw.org/reports/2004/rwanda0904/rwanda0904.pdf>
- ²⁵ Novovic S. and Petrovic, D., 'Women in Policing' (Republic of Serbia Ministry of Interior Police College: Belgrade), April, 2006, p. 35.
- ²⁶ Potter, A., *We the Women: Why Conflict Mediation is Not Just a Job for Men* (Centre for Human Dialogue: Geneva), 2005, p. 16.
- ²⁷ Lithander A. et al., *Engendering the Peace Process: A Gender Approach to Dayton and Beyond* (Kvinna till Kvinna Foundation: Stockholm), 2001, cited by Bouta, T. and Frerks, G. in *Women's Role in Conflict Prevention, Conflict Resolution and PostConflict Reconstruction: Literature Review and Institutional Analysis* (Netherlands Institute of International Relations – Clingendael Conflict Research Unit: The Hague), 2002, p. 45. It is important to emphasise that the integration of women into police forces in the postwar context may be due to pressure exercised by the international community. In Kosovo, for example, the OSCE mandated the inclusion of both women and ethnic minorities into the police. (For this point I am indebted to Rita Taphorn.)
- ²⁸ Burke, E., Klot, J. and Ikawebe, B., *Engendering Peace: Reflections on the Burundi Peace Process*, African Women for Peace Series (UNIFEM: Nairobi), 2001, Appendix 1.
- ²⁹ Moser, C. and Clark, F.C., 'The Gendered Continuum of Violence and Conflict: An Operational Framework', *Victims, Perpetrators or Actors? Gender, Armed Conflict and Political Violence*, (Zed Books: London and New York), 2001, p. 30.
- ³⁰ Bouta, Frerks and Bannon, p. 34.
- ³¹ Bouta, Frerks and Bannon, p. 47.
- ³² Human Rights Watch, 'Struggling To Survive: Barriers to Justice for Rape Victims in Rwanda', *Supra*, p. 32.
- ³³ Dahlerup, D. and Freidenvall, L., 'Quotas as a fast track to equal representation for women', *International Feminist Journal of Politics* 7.1 (2005), p. 26.
- ³⁴ UNRISD (2005); IPU, 'Women in National Parliaments', 31 Aug. 2007; IDEA, *Country Profiles*, 2007.
- ³⁵ McGrew, L., Frieson, K. and Chan, S., *Good Governance from the Ground Up: Women's Roles in Post Conflict Cambodia*, Washington DC: cited by Powley, E. and Anderlini, S.N. in 'Democracy and Governance' in *Inclusive Security, Sustainable Peace: A Toolkit for Advocacy and Action*, International Alert and Initiative for Inclusive Security, 2004, p. 36.

- ³⁶ Isha L'isha News Release, Parliament/Knesset Passes New Law Mandating Inclusion of Women for Peace and Security Negotiations & Policy', 21 July 2005. <http://www.peacewomen.org/news/IsraelOPT/July05/Knesset.html>
- ³⁷ Council of Europe, Gender Budgeting, (Council of Europe: Strasbourg), 2005, p. 10.
- ³⁸ DCAF and IPU, Parliamentary Oversight of the Security Sector: Principles, Mechanisms and Practices, (DCAF and IPU: Geneva), 2003, p. 130.
- ³⁹ IPU/UNDP/World Bank Institute/UNIFEM, Parliament, the Budget and Gender, (IPU: Geneva), 2004, p. 61.
- ⁴⁰ Council of Europe, Gender Budgeting, (Council of Europe: Strasbourg), 2005, p.14.
- ⁴¹ Byanyima, W., Politics, Good Governance and Gender: Gender Budgeting Experiences in Three African Countries', Fifth Global Forum on Reinventing Government: "Innovation and Quality in the Government of the 21st Century", Mexico City 37 Nov. 2003, p.3.
- ⁴² IPU/UNDP/World Bank Institute/UNIFEM, Parliament, the Budget and Gender, p. 75.
- ⁴³ IPU/UNDP/World Bank Institute/UNIFEM, Parliament, the Budget and Gender, p. 44.
- ⁴⁴ Reeves, H. and Watch, H., Women's and Gender Budgets: An Annotated Resource List, Institute of Development Studies, (BRIDGE: Sussex), 1999, p. 14.
- ⁴⁵ Byanyima, 'Politics, Good Governance and Gender', pp.69; World Bank Policy Research Report, Engendering Development, 270; IPU/UNDP/World Bank Institute/UNIFEM, Parliament, the Budget and Gender, p. 28.
- ⁴⁶ Council of Europe, Gender Budgeting, (Council of Europe: Strasbourg), 2005), pp. 17-18.
- ⁴⁷ Pankhurst, p. 20.
- ⁴⁸ Bouta and Frerks, p. 42.
- ⁴⁹ UN Division for the Advancement of Women, Report, Expert Group Meeting on Peace Agreements as a Means for Promoting Gender Equality and Ensuring Participation of Women. A Framework of Model Provisions, Ottawa, 1013 Nov. 2003, p. 12.
- ⁵⁰ UN Division for the Advancement of Women, Report, Expert Group Meeting on Peace Agreements as a Means for Promoting Gender Equality and Ensuring Participation of Women. A Framework of Model Provisions, Ottawa, 1013 Nov. 2003, p. 8.
- ⁵¹ Bouta, T., Frerks, G. and Bannon, I., Gender, Conflict, and Development, (World Bank: Washington DC), 2004, p. 49.
- ⁵² IPU/IDEA, Making Reconciliation Work: The Role of Parliaments, 2005, p. 10
- ⁵³ Freeman, M., Making Reconciliation Work: The Role of Parliament, Handbook for Parliamentarians No 10, (IPU/IDEA: Geneva), 2005, p. 11.
- ⁵⁴ Freeman, M., Making Reconciliation Work: The Role of Parliament, Handbook for Parliamentarians No 10, (IPU/IDEA: Geneva), 2005, p. 11.
- ⁵⁵ Anderlini, S.M., Conaway, C.P. and Kays, L., 'Transitional Justice and Reconciliation', Inclusive Security, Sustainable Peace: A Toolkit for Advocacy and Action, (International Alert and Women Waging Peace: Washington DC), 2004, p.9. http://www.womenwagingpeace.net/content/toolkit/chapters/Transitional_Justice.pdf
- ⁵⁶ Bastick, M., 'Ensuring Women's Involvement in the Full Reconciliation Process', Presentation to the Regional Seminar on the Role of Parliamentarians in the National Reconciliation Process in Africa, Bujumbura, Burundi, 79 Nov. 2005, p. 5.
- ⁵⁷ Akoun, L., Ivory Coast, personal interview, 19 Oct. 2005.
- ⁵⁸ Kadaga, A., Deputy Speaker of Parliament, Uganda, personal interview, Geneva, Oct. 19, 2005.
- ⁵⁹ Freeman, M., Making Reconciliation Work: The Role of Parliament, Handbook for Parliamentarians No 10 (IPU/IDEA: Geneva), 2005, p. 12.
- ⁶⁰ Anderlini, S.M., Conaway, C.P. and Kays, L., 'Transitional Justice and Reconciliation', Inclusive Security, Sustainable Peace: A Toolkit for Advocacy and Action, (International Alert and Women Waging Peace: Washington DC), 2004, p. 12. http://www.womenwagingpeace.net/content/toolkit/chapters/Transitional_Justice.pdf
- ⁶¹ Goldblatt, B. and Meintjes, S., 'South African Women Demand the Truth', What Women Do in Wartime: Gender and Conflict in Africa, eds. Turshen, M. and Twagiramariya, C., (Zed Books: New York), 1998, p. 29.
- ⁶² Pankhurst 21; Anderlini, S.N, Conaway, C.P. and Kays, L., 'Transitional Justice and Reconciliation', Inclusive Security, Sustainable Peace: A Toolkit for Advocacy and Action, (International Alert and Women Waging Peace: Washington DC), 2004, p. 6. http://www.womenwagingpeace.net/content/toolkit/chapters/Transitional_Justice.pdf
- ⁶³ Strickland, R. and Duvvury, N., Gender Equity and Peacebuilding: From Rhetoric to Reality (International Center for Research on Women: Washington DC), 2003, pp. 7-8.
- ⁶⁴ Rehn, E. and Sirleaf, E.J., Women, War, Peace (UNIFEM: New York), 2002, pp. 11, 13, 16.
- ⁶⁵ This paragraph is based on Luciak, I., 'Joining Forces for Democratic Governance: Women's Alliance Building for Postwar Reconstruction in Central America', Expert paper prepared for UNRISD's 10Year Evaluation of the Beijing Women's Conference 2004, UN Research Institute for Social Development, 2004, p. 30.
- ⁶⁶ Congreso de la República, Bancada de la Unidad Revolucionaria Nacional Guatemalteca, Femicidio en Guatemala: Crímenes contra la humanidad (URN: Guatemala City), 2005, pp.54-56.
- ⁶⁷ Bouta, Frerks and Bannon, p. 149.
- ⁶⁸ Correia, M., 'Gender', Colombia: The Economic Foundation of Peace, eds. Guigale, M. Lafourcade, O. and Luff, C., (World Bank: Washington DC), 2003, p. 146, cited in Bouta, Frerks and Bannon.
- ⁶⁹ IPU, Aug. 2007.
- ⁷⁰ DCAF and IPU, Parliamentary Oversight of the Security Sector: Principles, Mechanisms and Practices, (DCAF and IPU: Geneva), 2003, p. 27.
- ⁷¹ 'The Swedish Government's Action Plan to Implement Security Council Resolution 1325 on Women, Peace and Security', p. 34. http://www.osce.org/documents/odihr/2006/10/20979_en.pdf
- ⁷² Foreign Affairs Canada, 'Towards a Canadian National Action Plan to Implement Security Council Resolution 1325 on Women, Peace and Security', Third Annual Symposium of the Canadian Committee on Women, Peace and Security, Oct. 2005.
- ⁷³ IPU, 'Women in Politics', <http://www.ipu.org/wmne/suffrage.htm> Mosadiq, 'The New Afghan Constitution'.

